

# Oral History Kosovo

---

## INTERVISTË ME BINAK ULAJN

Prishtinë | Data: 15 korrik, 2022

Kohëzgjatja: 131 minuta

Të pranishëm:

- Binak Ulaj (I intervistuari)
- Anita Susuri (Intervistuesja)
- Renea Begolli (Kamera)

*Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:*

*() - komunikim emocional*

*{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste*

*Simbole të tjera në transkriptë:*

*[ ] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin*

*Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.*

## **Pjesa e Parë**

**Anita Susuri:** Zoti Ulaj, nëse mundeni me u prezantu fillimisht? Datën e lindjes, vendin, diçka për familjen e juaj, prejardhjen?

**Binak Ulaj:** Jam i lindur me 15, të 3-tit, 1944 në fshatin Vuthaj të Luginës së Plavës dhe Gucisë. M'u aty pranë kufirit që ndanë trugun e atdheut tonë, se ne jena konë të ndarë me vite për së gjalli. Në ni familje tipike malësore, natyrisht të varfër, për arsye se shumica e vendasve të asaj pjesëve të banorëve shqiptare që janë vendas, anas [të asaj ane], kanë qenë të varfër. Përveç kësaj, nuk kanë pasur mundësi që të krijojnë kushte ma të mira jetese, për arsye se në viset pranë kufitare të banuar me shqiptarë vendas, do të thotë, anas, është udhëhequr ni politikë e veçantë jo vetëm shkombëtarizimi, po ni politikë për t'i zhvendosur nga aty dhe për ta populluar atë vend me elementin sllav. Për arsye se popullimi me elementin sllav do të ishte garanci për sistemin jugosllav, për ruajtjen e kufirit.

Ndërsa, ne, do të thotë, nuk ishim ata që ishim të interesuar ta runim atë kufi. Ai kufi, do të thotë, ishte, na ka shkaktuar shumë dhembje, shumë tragjedi, madje edhe humbje jete. Prandaj, po them edhe niherë, jam rritur me ni familje të tillë, me shumë vështirësi dhe natyrisht unë si i vogël ato nuk i vlerësoj unë aq sa, si i vlerësoj tani. Shkollimin fillor e kam kryer po ashtu në vendlindje, por në vitin '56-57 do na mbyllin edhe shkollat. Do të thotë, me arsyetimin nën thojza se ku do të gjeni punë në ish Jugosllavi, në Jugosllavi. Popullsia vendase ishte, e kishte të pamundur të kundërshtoj vendime të tilla. Ata që i kundërshtonin vendimet e qeverisë konsideroheshin pastaj armiqë dhe ndaj tyre ushtrohej përsëri një presion shtesë.

Prandaj, po them edhe niherë, ka qenë ni fëmijëri me shumë vështirësi, ni fëmijëri me shumë vështirësi. Ni fëmijëri e cila për falë, falë faktit që prindërit tanë kanë qenë shumë arsimdashës, do të thotë, nga Vuthaj besoj se osht' numri ma i madh krahasuar me numrin e banorëve prej të gjitha fshatrave kudo qofshin shqiptare. Kjo ka pasur rëndësi të madhe. Dua të theksoj edhe diçka tjetër, për fat do të thotë. Për ne ishte ni fat i madh pas mbylljes së shkollave shqipe, fakti që në qendrat tjera të Kosovës, në Pejë, në Prizren, në Gjakovë, në Prishtinë, ne jo vetëm që ishim të mirëpritur por ishim të privilegjuar. Do të thotë, ne pranoheshim më lehtë në shkollat e kësaj pjese të Kosovës sesa nxënësit vendas.

Për arsye se, vlen për t'u theksuar edhe do të jemi për jetë mirënjohës atyne mësimdhënësve shqiptarë të cilët e vlerësonin pozitën tonë, e vlerësonin pozitën e gjendjes shqiptare në viset kufitare që ishin qoftë në Mal të Zi, qoftë në pjesë tjera, në Preshevë ose Maqedoni e kështu me radhë. Për shkak se, ju si t'ë eja nuk e di a e dini, qeveria e Beogradit në krye me Titon, jo vetëm që nuk i la të jenë kompakte, unike trojet shqiptare, po përkundrazi, do të thotë, i copëtoi. Një pjesë me Maqedoninë, ni pjesë me Serbinë, Mal të Zi edhe kështu me radhë.

Për arsye se, për nga numri i popullsisë, e dini se, populli shqiptarë ishte populli i tretë. Po në qoftë se do të ishim bashkë, do të thotë, edhe territorialisht, do të thotë, përbënim ni faktorë me rëndësi, do të thotë, edhe politike. Kështu që, do e përsëris edhe niherë, do të thotë, ky ishte fati ynë. Fati ynë që jo vetëm të shkolloheshim po edhe të mos asimiloheshim edhe ta ruanim identitetin tonë. Shkollimi i gjithë këtij numri të rinjëve, se nuk e di a po ju them, se mesatarisht çdo familje vuthjane, mesatarisht e ka s'paku nga një, nga dy me fakultet e tutje. Kemi akademikë, doktorë shkencash, mos t'i përmendi, brenda edhe jashtë. Tani, kjo osht' ajo pjesa shkurtimisht e jetës time, do të thotë, shkollimi edhe tjera.

Tani noshta do të ju intereson me siguri ajo cili ishte motivi që unë jom angazhuar dhe jam inkuadruar në Lëvizjen Kombëtare Çlirimtare të Kosovës, Lëvizjen Ilegale si e quajmë. Disa e quajnë, lëvizje, do të thotë, klandestine. Po ma e drejtë do të jetë Ilegale, s'këm nevojë që... ju thashë që, derisa ishim në bisedë përjashta, do të thotë, unë e kisha edhe ni motiv tjetër shtesë personal. Pasiqë jam shkolluar, do të thotë kam kryer gjimnazin pastaj studimet, ni pjesë gjimnazin e kom kry në Prizren, pastaj Shkollën e Lartë në Prizren, pastaj kam kaluar në Prishtinë ku i kom përfunduar studimet e shkallës së parë, të dytë dhe të tretë.

E kisha edhe një motiv shtesë, ju thashë personal, gjithë ato vlime në Kosovë, gjithë ajo revoltë, ato protesta, ajo luftë e të rinjëve e të rejave s'mund të isha unë, t'i shikoja vetëm nga dhoma ose nga rruga do të thotë. Dhe kisha motivin tjetër personal, e llogarisja se nesër kur të takohem me dajtë e mi, me dajtë e babës, me të afërmit e tjerë, se i kishim në krahun tjetër të atdheut, në Tiranë, në Durrës e tjera. Thojsha, po që se ata do të më pyesin, po mirë, po ti Binak ku ishe gjatë këtyre demonstratave, vlimeve, protestave? Çka do të thosha? Ishte kjo motiv shtesë.

Tjetër motiv shtesë familjar, personal do të thosha, ishin lotët e nënës. Ajo për vite të tëra, pas '48-tës deri në, disa dekada nuk ka arritur jo vetëm t'i shoh nënën, se baba i ka vdekë herët, vllain e të afërmit e tjerë po ni kohë nuk kemi mujtë as të komunikojmë me letra. Mos të flasim për mënyra tjera të komunikimit. Kështu që, ishin këto motive edhe niherë. Pastaj, natyrisht që si i ri që unë e kisha përjetu drejtpërsëdrejti, shtypjen, presionin, që ju thashë që ushtrohej ndaj popullsisë, ndonëse nuk e vlerësoja kur isha i ri në nivelin që duhej po e shihja, e ndjenja.

Do të thotë, ishin elemente që bonën që të takohem, të lidhem dhe të shoqërohem kryesisht me atë kategori, me ata djem edhe ato vajza të atyre familjeve që kishin ni edukatë të shëndoshë atdhetare.

Kjo edhe sot e kësaj dite më bën të lumtur që kom pasë fatin që të jem pjesë e kësaj shoqnie. Atyne djemve edhe vajzave dhe që kanë dhanë, atë, disa prej tyre edhe jetën për lirinë e Kosovës, për të mirën e atdheut.

**Anita Susuri:** Zoti Binak, para se me vazhdu me aktivitetin e ju, po du me u kthy në disa pika që i përmendët se po m'duken interesante. Për shembull, përmendët për dajtë e ju që kanë qenë, në Shkodër po më duket thatë...

**Binak Ulaj:** Rrethi i Shkodrës, në Malësi të Shkodrës.

**Anita Susuri:** Histori familjare e Luftës së Dytë Botërore nëse mundeni me...

**Binak Ulaj:** Që tani, të ju them edhe diçka. Do të thotë, gjyshi im ka qenë, gjyshi ka qenë pjesëtar i lëvizjes kundër pushtimit Turk. Madje, ka qenë edhe pjesëmarrës në aksione kundër, ka qenë pjesëmarrës në shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë, 28 nëntor '12-ën në Vlorë. Përmendet emri i tij në historinë e Vuthajve, por unë nuk kam gjetur dokumente dhe nuk e kam theksuar shumë këtë çështje. Për arsye se, meqë nuk kisha dokument, përveç librit, ni monografie të shkurtë për Vuthaj, nuk e kam ritheksuar shumë.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, do të thotë, po ju them edhe këtë, ju e dini se pushtuesit nazi-fashist e kanë nda Kosovën, trojet shqiptare në pjesë, zona të interesit të tyre. Pjesa e Plavës e Gucisë kanë qenë nën pushtimin italian. Por, ata si pushtues, do të thotë, edhe për t'i përvetësuar masën e popullsisë, do të thotë, ata deklarohen, tregohen, në thojza po them, shumë tolerant duke i pyetur vendasit, "Doni ju me qeverinë e Tiranës apo me qeverinë e Beogradit". Natyrisht se populli çka do të deklarohej? Do të deklarohej se don me qeverinë e Tiranës. Por, çka vendosin ata? Thotë, "Meqë doni ju të jeni të pavarur ose të mos jeni nën direktivat e Beogradit, atëherë duhet ta mbronni vetë, t'i mbronni vetë trojet shqiptare të Plavës dhe Gucisë nga serbët, malazezët" e kështu me radhë, se ata gjithnjë synonin që këto pjesët t'i kenë nën kontrollin e vet.

Flas edhe për njësitë partizane, nuk dua t'ju flas për... besoj që mund të dini se në radhët e njërive partizane-jugosllave janë veçmas në fund të Luftës së Dytë Botërore janë përfshi shumë çetnikë të cilët kanë vazhduar atë politikën gjenocidare ndaj popullit shqiptar ose i kanë zbatuar masat e Beogradit e tjera. Gjatë luftës, do të thotë, në nifarë mënyre Plava edhe Gucia kanë përjetua edhe popullsia e vendit, ni lloj, ta them kushtimisht, ni lloj lirie ndaj një pushtuesi ma i zbutur se që ishte Jugosllavia. Po, megjithatë ai ishte pushtues. Fakti që këta ishin rreshtuar, do të thotë, në grupe të organizuara për ta mbrojtur Plavën e Gucinë nga, e tash të them edhe njëherë, nga njësitë ushtarake, serbe, malazeze e kështu me radhë.

Me të përfundu Lufta e Dytë Botërore, do të thotë, ata edhe me të hyrë njësitë jugosllave në Plavë e Guci, detyrohen prindtë e mi dhe vendas tjetër të ikin në krahun tjetër të atdheut. Për të shpëtuar

kokën ashtu siç kishin ikur në vitin 1913, kur pushtohet Kosova e Plava e Gucia. Në vitin 1918-19 pas tërheqjes së Austro-Hungarisë tri herë janë djegur vendbanimet shqiptare të Plavës dhe Gucisë. Edhe herën e tretë janë djegur me të përfundu Luftës së Dytë Botërore. Pse e them këtë? Pasojë e kësaj politike të përndjekjes do të thotë se sot në fshatin Niksiq që osht' në rrethin e komunës së Plavës, prej vitit 1980 nuk ka më asnjë shqiptarë. Në fshatin tjetër po ashtu afër, Arzhanicë që quhet aty kanë mbetë vetëm dy familje shqiptare, të cilat po që se do i vizitonte njeriu do të sheh se si bohët asimilimi i dhunshëm i tyre në kushte, në kushte... për arsye se janë të rrethuar kryesisht me banorë malazezë të cilët janë kolonë, do të thotë.

Se pas 1913 kur pushtohet Plava e Gucia, Mali i Zi ka sjellë ka shumë kolonë në viset shqiptare. Po ashtu edhe në fshatin Pepaj, mund të merrni me mend osht', vetëm në djallë i ri shqiptar që jeton aty edhe nuk e di a osht' ende aty, të gjithë të jerët nuk janë. E thashë edhe niherë, gjatë Luftës së Dytë Botërore prindtë e mi kanë qenë të detyruar të ikin si shumë të tjerë për të shpëtuar kokën. Jo që kanë qenë kundër partizanëve ose kundër Luftës Nacional-çlirimtare, këta ta kemi parasysh, por ata kanë qenë për të mbrojtë qat' deklarim të tyre që të jenë së bashku me Tiranën, përkatësisht me pjesën tjetër të Shqipërisë. Kjo është arsyeja.

Unë kam lindur, pastaj gjatë lindjes... kam lindë në Bjeshkë të Kelmendit, konkretisht në Bjeshkë të Niksiqit. Diku në vjeshtë, domethonë kjo datë nuk osht' e saktë, domethonë, nuk e di për arsye sigurisht, për qëllime për të mshefur ndonjë qëndrim ose aktivitet tjetër më kanë shkru përpara, do të thotë disa muj. Kam lindur diku në vjeshtë. Bile mahitesha me nanën, thojsha, "Nanë me cilën datë?" "Po ç'ke datë lokjo", thojke, "po s'na binte ndërmend për data, s'e kishim atë dite për data. Po ke lindë atëherë kur", se kjo osht' pak ndoshta interesant nëse, kushdo e ndëgjon, "kur e kem shti korën në kosht", domethonë, kur e kem korrë misrin. Do të thotë, kjo do të duhej të jetë diku nga fundi i shtatorit ose në tetor.

Fakti që nana ime ka lindë në mal, gjatë ikjes, do të thotë, në kushte jo profesionale, do të thotë, pa ndihmë profesionale në kushte të ashpra të vjeshtës, çfare din të jetë në Alpet Shqiptare. Ka qenë, mendoj unë, shkak që nana ime pastaj s'ka pasë fëmi tjetër. Për të qenë edhe ma e rëndë jeta e saj, do të thotë, babai vdes herët, do të thotë, në vitin '73, '73. Kështu që, nana ime, do të thotë, i mbetet në barrë shumë ma e randë, përveç mërziisë për të afërmin e vet tani edhe kujdesi për mue...

**Anita Susuri:** Fëmi tjerë s'ka pasë?

**Binak Ulaj:** Ju thashë, do të thotë, kjo ka qenë lindja e parë dhe për shkak se ka lindë pa ndihmë profesionale dhe në rrethana të tilla, domethonë ka lindur, ka lindur në dbar, ju e dini çka osht' dbari? Disa i thojnë stan. Osht'...

**Anita Susuri:** Barinjte ku rrinjë?

**Binak Ulaj:** Ndërtesë si në bjeshkë, të ndërtuara me mure të thata, pa lloç ose pa mallter si i thuni në gjuhën e huj. Me ndihmën e grave që kanë qëlluar aty edhe kjo do të thotë osht' ajo periudha e Luftës së Dytë, do të thotë, jo vetëm që, jo pse vendasit që kanë ikur pas Luftës së Dytë kanë qenë kundër por ata janë deklaruar se do të jenë me qeverinë e Tiranës dhe e dyta do të thotë, për fat ata nuk kanë bërë krime. Nuk kanë bërë krime, kanë mbrojtë aq sa kanë mbrojtë. Çka të them tjetër? Nana ime pasaj, ajo më ka rritur dhe më ka shkolluar falë profesionit të saj. Ajo ka qenë një artizane e veçantë, e rrallë e asaj pjese. Nuk besoj, mos mendoni se po e lavdëroj së tepëri, po nuk ka pasë grua që i ka përgatitur një pjesë të veshjes kombëtar si nana ime. Pshtjellakun të ngjashëm me veshjen e Rugovës, që e dini se edhe Rugova janë Kelmendas si në Vuthaj edhe kracat. Do të thotë, ajo nuk ka arritur, do të thotë, t'i plotësoj kërkesat. Kjo rrjedhë nga fakti se nana ime duke qenë e rritur në Malësi të Shkodrës, atje çdo, po them kushtimisht çdo, s'jom i sigurt por megjithatë ka peshë të dihet se vajzat para se të shkojnë nuse kanë qenë të obliguara që vet ta përgatisin pajën, xhubletën. Ju e dini xhubleta çka është?

**Anita Susuri:** Po, po.

**Binak Ulaj:** Veshje malësore. Xhubleta ka shumë gajtane, osht' veshja ma e lashtë besoj në, në, në, nuk e di tash a të them, në Europë. Po keni dëgju, do të thotë, osht' mbi sa mijë vjeçare e lashtë. Falë punës së saj, mjeshtërisë t'ësaj, të cilën e ka bo me aq vullnet. Pothuajse gjatë gjithë jetës kemi arritë, do të thotë, unë kam arritur ta kem një shkollim pa probleme të randa financiare, do të thotë. Madje, madje edhe pasi jam shkolluar ajo ka vazhduar punën diku deri në vitin, deri nja tri vite, katër para se të ndrrojë jetë. Ka jetu diku afër 95 vjet. Kështu që kjo është ajo e gjitha që do të thosha shkurtimisht edhe për familjen edhe për gjendjen gjatë Luftës së Dytë.

**Anita Susuri:** Deshta me ju pytë diçka se po më intereson...

**Binak Ulaj:** Urdhnoni.

**Anita Susuri:** Si janë martu prindtë e juv prej Malësisë së Shkodrës, për shembull nana?

**Binak Ulaj:** Dëgjo tani, do të thotë, ju e dini se, se pjesa e Plavës dhe Gucisë ashtu edhe pjesë të tjera kanë qenë të ndara në vilajete. Plava e Gucia osht' shumë afër, bile në vijë ajrore me Shkodër, me Krasniq, me Bajram Curr dhe kanë pasë ni... para Luftës së Dytë Botërore, do të thotë, krypen, vajin, gazin ato për ndriçim, se përpara jemi ndriçuar me vaj guri, e dini a? Do të thotë, i kemi marrë në Shkodër. E dyta, pas pushtimit të Plavës dhe Gucisë në '13-ën, shpëtimin e kanë gjetë në atë pjesë dhe njerëzit janë njohur, janë miqësue.

Tregtia, shembull po e marrë, prej Thethit, ju nuk di, keni qenë ndoshta, Shala ajo pjesë, Bajram Curri e knej kanë dajë, nipër janë martu, kanë lidhë martesë. Do të thotë edhe kjo ka qenë edhe nifarë forme që, që ta kesh një mik po e zamë në ni pjesë ku kalon anej, ku shkon disa herë për nevoja të

domosdoshme kishte peshë të veçantë. Kështu që, njerëzit janë njoftë dhe janë miqësue me atë pjesë deri në vitin '48.

Mandej, këto martesë për shkak të mbylljes hermetike të kufirit, do të thotë janë ndërpre. Fatbardhësisht tash ju të ritë e të rejtat besoj që keni parasysh që të zgjeroni rrethin edhe të atyre shokve të jetës që do i zgjedhni, të mos shikoni, të mos bëheni lokalista do të thotë. Ndonjë korçar, ndonjë vlonjat, ndonjë sarandnjat, ndonjë... ka peshë kjo se kështu do të bëhet integrimi i kombit. Rrafshohen ato dallimet edhe zakonet. Urdhno të lutëm!

**Anita Susuri:** Deshta edhe me ju pyetë, për nanën më tregutë po për babën a e kujtoni? Çfarë moshe ka qenë kur ka ndrru jetë edhe qysh ka ndrru jetë?

**Binak Ulaj:** Babi im si ka ndrru jetë? Babi ka ndrru jetë në moshën 50 vjeçare. Edhe jeta e tij ka qenë e randë, ka qenë e randë për arsye se edhe babain tim edhe nanën, si nanën, edhe axhën tim edhe hallat e mija kanë mbetur herët pa nënë. Gjyshi im, për shkak të autoritetit që ka pasur, për shkak të miqësisë por në rend të parë edhe për shkak të asaj, si me thanë, që e dëgjoja ka fliste se jo që më thoshte se isha i ri se edhe ai ka vdekur do të thotë kur kam qenë i ri. Për shkak të faktit që s'ka dashur t'i përziej fëmijtë, nuk është martuar më. Kështu që, dhe babai im osht' rritë pa nënë, është rritë nën përkujdesjen e babit. Për fat të keq i kanë vdekur edhe dy motrat.

Du të ju them edhe diçka, meqë është rrëfim personal kjo ka peshë të dihet. Njëra prej motrave, se gjyshi im ka qenë shumë i gjatë, unë nuk e di, kom ngja si duket prej dajve të mi. Gjyshja ime ka qenë po ashtu e gjatë. Kanë qenë shumë të bukur. Ka qenë aq e bukur halla ime, që unë s'e mbaj mend, se ka vdekë e re saqë ia kanë qitur emrin Keqe, për t'mos e marrë msysh, sipas bestytive. Kjo osht' pak ndoshta kështu, osht' diçka interesante. Unë nuk i mbaj mend se ato kanë vdekur. Pastaj, po them edhe niherë, meqë gjyshi im, ne kishim pak tokë atje. Atëherë nuk kishe mundësi që...

Dëgjoni, aq ka qenë presioni i madh, i vetmi fshat në komunën e Plavës e Gucisë, i cili, në të cilin ka pasë postë të ushtirësë kufitare jugosllave. Postë, ushtari, e kuptoni çka osht' posta? I vetmi fshat ku ka qenë, përveç postës së ushtrisë kufitare ka qenë edhe posta e policisë mrena në fshat. Nuk ke mund të kesh një lëvizje, nuk na lejonin në qoftë të shkojmë... na mbetej, shembull po e marr, lopa në mal ka qenë e pamundur të shkojmë ta lypim. Meqë verës nuk na lejonin dru të merrnim në mal, dru të thara, mali osht' i shtetit domethonë. Gjenin njëqind mijë mënyra për të detyru popullsinë që të shpërngulet prej andej.

Fatbardhësisht, prej '66-ës do të thotë, e dini, këto masa zbuten. Ndonëse, qeveria e Beogradit edhe e Podgoricës nuk heqin dorë nga ato synimet e tyre. Natyrisht tash do të jenë masat pak ma të zbutura, po edhe ma prefide. Këtë po e them për arsye se sot dy të tretat e popullsisë shqiptare të Plavës dhe Gucisë janë jashtë. Dy të tretat, kjo osht' pasojë e asaj. Po them, ne deytroheshim, deytroheshim dimrit t'i ulim drutë për borë zhag prej maleve që janë në lartësi për t'i tërhequr nëpër borë. Më kujtohet, nuk

na lejonin që drutë pastaj të thata t'i shesim, le mo të njoma. Nuk kishe kah e fitoje atëherë dinarin jugosllav, s'kishe kah. I kursenim ato t'shkreta pak nëse kishim vezë, ato i shisnim. Ose nëse bylmetin që e mblidhnim, do të thotë, ushqeheshim, kursenim shumë nga prodhimet e qumështit se s'kishim çka tjetër.

Qumështit ia nxjerrim njëqind yndyra që i kishte, se atëherë nuk kishim të blinim edhe nuk përdorej vaji për ushqim çfare përdorim tash. Babai im ishte i detyruar të punojë, të bëjë punë të rënda krahu. Fakti që ka punuar, fakti që është dashur që të bëjë punë shumë të rënda edhe fakti që ka qenë po ashtu ni punëtor jashtëzakonisht i përkushtuar ndaj punës edhe i ndershëm, në nifare mënyre njerëzit nuk e linin që të marrë frymë. Ai ka qenë i tillë sa që nëse ka marrë, për shembull, ka shkuar të punojë, t'ia kryej ni punë dikujt nëse nuk ka arritë apo nuk e ka kry, po zamë, ka thanë, "Jo, qe për ni orë e kryejmë".

Mandej ka qenë mjeshtër i shumë profesioneve të punëve të krahut. Kostar, me kosë domethonë ka kositë se s'ke pasë atëherë mekanizëm për kosjen e livadheve. Mjeshtër i mureve, i mbulimit të shtëpive dhe kjo si duket, kjo punë e randë ia ka shkatërruar veshkët. Pastaj, përveç veshkëve i është shkaktuar edhe sëmundja e mushkërive duke fjetur në kushte jo të përshtatshme, se duke bërë punë të randa. Pastaj ka pasë edhe sëmundjen e zemrës dhe është bërë një kompleks i sëmundjeve.

Kështu që, kur ka ardhë para se të vdesë në Prishtinë të më vizitojë, unë atëherë sapo kisha dalë, e kisha kryer shërbimin ushtarak. E shoh se ishte dobësuar... iu ishte shkaktuar, harrova të them, edhe sëmundja e sheqerit. E shoh që është dobësuar shumë edhe i thom, jo m'ë thotë mua, "Po edhe ti po më dokesh pak i dobët", thotë. Edhe kishte qenë çdo gjë vonë atëherë. Do të thotë, me 13 janar, '73-tit veç ndërron jetë. Kryesisht prej punës, punës së rëndë për të na mbajtë.

Për arsye se atëherë ishim edhe me ni familje me axhën, ai ka pasë atëherë gjashtë fëmi, gjashtë djem, nusën e kështu me radhë. Kërkesat ishin shtuar, nevojat, nevojat familjare dhe ai përpiqej që asgja të mos na mungojë.

## Pjesa e Dytë

**Anita Susuri:** Më tregutë që keni qenë fillimisht në Prizren për me vazhdu shkollimin, qysh ka qenë kjo, ky transfer prej vendit t'lindjes?

**Binak Ulaj:** Po të thom, tash ajo çështja e Prizrenit, du të them diçka, për mue kur kom ardhë në Prizren dhe e shoh ni të ri aty që shkrunë kërkesën për t'u pranuar. Se atëherë bënim kërkesën për t'u pranuar në gjimnaz. E shoh që nuk e shkruan as serbisht, as shqip. I thom, "Po çfarë gjuhe?" Thotë, "Turqisht". Më ishte dukë sikur të më thoshit ju sot, por sot osht' normale a, po shkrun kinezisht. Nuk e dija që ka turqi në Kosovë. Nuk e kisha dëgju se ndoshta edhe kontaktet kanë qenë, po unë për herë të

parë kur kom ardhë në shkollë të mesme, kom ardhë në këtë pjesë të Kosovës. Kështu që, nuk e kam ditur atë.

Siç e thashë në fillim, kem qenë të mirëpritur në shkollë, kemi qenë të përkrahur. Ndonëse, nuk e dinim atëherë mirë gjuhën, e përzinin me gjuhën sllave, me gjuhën serbe e tjera e tjera, do të thotë. Po në Prizren, për mu ka qenë me rëndësi edhe duhet ta theksoj, fati im njohja me familjen Braha, [Meriman Braha](#), besoj ti që je e Prizrenit edhe keni dëgjuar [i drejtohet intervistuesës]. Ajo ka qenë ni familje në cilën kam shku shpesh, më kanë marrë faktikisht si, edhe jo pa qëllim, si anëtar të familjes së tyre, më kanë trajtuar ashtu.

Kurse unë kam banuar po ashtu edhe me ni familje tjetër të njohur që përjetë u jam mirënjohës, familja Karagliju. Jam ushqyer me ni sofër me ta, kanë pranuar të ushqehem me ni sofër me ta, me djalin e tyre që ishte nxanës i klasës, shok i klasës. Për mue veçmas, familja e Merimanit ka qenë ni familje ku sa herë kam shkuar, nuk ka ndodhë të mos bisedohet çështja Kosovë-Shqipëri. Çështja e qenies së Kosovës. Kështu që, edhe kjo familje ka qenë një, unë e kam qujtë, institucion familjar i atdhetarizmit. Nuk osht', ka qenë e pamundur të mos debatohet, të mos flitet raportet Shqipëri-Kosovë, gjendja e Kosovës e tjera e tjera. Ka qenë e pamundur!

Pastaj, me anëtarët e kësaj familje, veçmas me Merimanin me të cilin kemi qenë edhe shok të klasës, do të thotë do bëhemi edhe shok të jetës edhe shok të idealit të përjetshëm. Ajo që më ka, ndoshta s'ka shumë rëndësi, nuk kam arritur ta mësoj turqishten. Nuk e di, për fat të keq ndoshta ajo dekada ime, turqit e tjera e tjera. Tash natyrisht e gabueshme, po e kisha ni lloj, mos të them edhe niherë, ni, jo urrejtje ndaj gjuhës se kur flitnin turqisht... po ajo që unë e besoja si që meritonte ni masë, ndonëse nuk e shfaqte.

Njerëzit të cilët disa vite më parë kishin ardhë në Prizren flisnin turqisht edhe në shtëpi. Të flasës turqisht atëherë, tash për fat ka ndrru gjendja po ishte ni lloj dëshmie që je qytetar. Kjo më pengonte atëherë. Thashë edhe niherë unë me ni edukatë pak prej malësori kam qenë ndoshta pak në këtë situatë, ndoshta pak ma jo mirëkuptues, mos të them refuzues. Ishte diçka që nuk ma donte shpirti.

**Anita Susuri:** Qysh ka qenë për juve si i ri jeta kulturore, shoqërore në Prizren? Atmosfera?

**Binak Ulaj:** Dua të ju them diçka, osht' mirë se tash njeri pyetjet osht' mirë gjithnji. Po them diçka, jeta kulturore ka qenë shumë e kufizuar atëherë, megjithatë ka qenë ni jetë e organizuar. Nuk kem pasë sikurse tash atëherë, do të thotë, nuk kem pasë kafene, nuk ka pasë, si i qujmë ne kto kafiqa. Muzikë, muzikë çfare të perëndimit e tjera. Për ma tepër, po ta them edhe këtë, që është mirë ta dini, do të thotë, ne kemi pasur kujdes pasi jemi organizu, kemi filluar të organizohem, të organizohem. I kemi caktuar vetit për detyrë se rruga jonë është me... do të jetë ndryshe nga ajo e Rinisë Jugosllave.

Për arsye se ne jemi të ri, po jemi të ri të një, të ritë e një pjese të atdheu të pushtuar, dhe nuk mund të jemi ne si ata. Ne kemi tjetër detyrë. Ne kemi detyrë të ngritemi dhe të formohemi, të vetëdijësohemi për t'i shërbyer këtij atdheu, përkatësisht lirisë së këtij atdheu. Kemi pasur kujdes jo vetëm në leximin e literaturës, aq sa kishim se ne s'kishim atëherë. Nuk i dinim gjuhtë e huja të lexojmë, ta zamë, literaturë në gjuhë angleze ose... e vetmja literaturë që mund të lexonim diçka ma shumë ishte literatura në gjuhën serbe.

Ne kishim kujdes edhe si t'veshemi. E kishim për detyrë, do të thotë, edhe me pamjen tonë edhe me veshjen, mos të kemi floktë të gjata, mos të jemi me mjekrra, atëherë ka qenë e pamundur e kështu me radhë. Përveç kësaj, do të thotë, ne kemi qenë thjeshtë të frymëzuar nga kultura çfare ishte në Tiranë. Kemi qenë të frymëzuar nga ajo kulturë që vinte prej andej, kemi qenë të frymëzuar me ato këngë, me ato emisione televizive. Ky ka qenë fati ynë të cilin, fati ynë po them edhe niherë, i cili na ngriti dhe na formoi që të marrim rrugën e duhur për t'u vënë në shërbim të atdheut.

Të jeni të bindur, se tash dikush do të thotë, jo ka qenë ideologji komuniste e tjera. Nuk duhet të harruar se ajo, roli që ka pasë Tirana në edukimin e të rive që i kanë takuar dhe i kanë inkuadruar në Lëvizjen Kombëtare Çlirimtare të Kosovës, ka qenë vendimtare. Shoktë e mi, po i zamë, unë s'du t'i jap me emër ose edhe unë p'i thom, i kom përcjellë që të kalojnë kufirin, që të na sjellin literaturë prej anej edhe t'i koordinojmë veprimet. Ne nuk mund të bazoheshim, do të thotë, në... s'mund të ktheheshim thjeshtë nga Beogradi. Ne jemi bazuar kryesisht në përvojën e Lëvizjes Çlirimtare të Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri.

Organizimi i celulave e tjera e tjera, këtë duhet pasur parasysh, nuk mund të mohohet roli që ka pasur propaganda e Shqipërisë, ndihma e Shqipërisë në Lëvizjen Ilegale. Po që se do t'ishim, po them edhe niherë, të orientuar drejt, drejt kulturës së perëndimit atëherë, lëvizja nuk do të kishte avancuar.

**Anita Susuri:** Nuk do të ekzistonte ideali ndoshta.

**Binak Ulaj:** Jo, ideali mund të jenë se tash ideale mund të kesh. Po nuk ishte ai ideali i çlirimit, do të thotë, ideali i lirisë, ideali i lirisë.

**Anita Susuri:** Po.

**Binak Ulaj:** Nuk do të thotë që nuk e dëgjonim muzikën. Unë për veti kisha qef edhe atëherë ndodhte të dëgjoj Beatles ose Rolling Stones ose shembull po e marr, i dëgjonim. Por, ishte problemi që këtë, do të thotë, nuk i adhuronim në atë masë ose nuk i nënçmonim. Shembull po e marr, këngëtarët tanë, kulturën çfare ishte e Tiranës e kështu me radhë.

Bile, po e tregoj ni rast, ka ndodhë me ni aksion gjatë studimeve, ni pjesë e anëtarëve të grupit tonë kanë hy edhe i kanë thy instrumentet në barakën e Konviktit të Studentëve. Ua kanë thy, që bonin

muzikë ma me kitare elektrike e kështu me radhë. Për arsye se ne donim, thjeshtë, kryesisht... do të thotë, ishim të orientuar m'u drejt ni qëllimit të cilit edhe i shërbenim. Ndoshta në ni mënyrë çfare mund t'i shërbejnë njerëzit të cilët janë nganjëherë ndoshta skajshmërisht idealista, që nuk i marrin parasysh rrethanat ideale ekzistuese.

Por, fatbardhësisht që osht' qashtu se po të kishte qenë ndryshe, t'i vlerësonim kushtet, se t'i kundërvihesh atëherë ni regjimi edhe ni shteti çfare ishte Jugosllavia që për shumëçka, veçmas për shpenzimet që bonte për ushtri edhe për polici do mund të quhet shtet policor.

**Anita Susuri:** Deshta me ju pytë edhe për gjimnazin, keni qenë në "Gjon Buzuku" ndoshta?

**Binak Ulaj:** Urdhno?

**Anita Susuri:** Në Gjimnazin "Gjon Buzuku" keni qenë në Prizren?

**Binak Ulaj:** Kom qenë në gjimnazin tash quhet "Gjon Buzuku" atëherë osht' qujtë me emrin e ni luftareje serbe, "Jovan Radivojeviq Ivkica".

**Anita Susuri:** Ka qenë gjimnaz, po mendoj, si me renome kështu...

**Binak Ulaj:** Gjimnazi i Prizrenit, gjimnazi i Pejës, kanë qenë gjimnaze, ndoshta edhe gjimnazi... atëherë gjimnazet kanë qenë shkolla, janë, po them edhe niherë, kushtimisht a, shkolla elite. Aty kanë shkuar ma tepër, ma tepër, se në gjimnazet kanë qenë shkolla ku ata që i krynin mendonin që të shkojnë në studime. Se me gjimnaz ka qenë atëherë e pamundur, e pamundur të mos them po të mos gjes, të gjes punë. Ke shku në gjimnaz, ke shku me qëllim që t'i vazhdosh studimet, ta vazhdosh shkollimin. Ke shku në Shkollë Normale, Ekonomike, Bujqësore e tjera e tjera, ti e ke pasë ni qëllim që ta krysh atë shkollë.

Prandaj, po them edhe niherë, gjimnazet kanë qenë, ka qenë gjimnaz i përzier. Disa lëndë i kemi pasë në gjuhën serbe. Por, kuadri arsimor po iu them edhe niherë, unë tash e kam parasysh edukatën arsimore, qytetare, atdhetare të mësimdhanësve tanë. Kam bindjen shumë që kuadri i sotshëm nuk i ka ato, këtë bindje e kam. Nuk i ka ato cilësi, nuk e kanë atë, jo vetëm këtë, po nuk e kanë as, do të thosha, tash karakteri osht' ni nocion i gjerë por nuk i kanë as ato ideale çfare i kishin ajo kategori e arsimtarëve. Flas për shumicën, kishte ndoshta përjashtim, po flas për shumicën e tyre.

**Anita Susuri:** Deshta me ju pytë për profesorët, që fillutë vet me tregu, për shembull historisë profesorin ose letërsisë. Çka ka qenë e ndalume, çka osht' mësu?

**Binak Ulaj:** Dëgjo të lutem, këtu duhet ta keni parasysh do të thotë, historia jonë mësohej tejmas e reduktuar ose fare. Për Shqipëri nuk bohej fjalë të mësonim. Përmendej, domethonë, histori e vjetër e

ilirëve, Lufta lliro-Romake, periudha turke deri në ni masë. Pjesa tjetër nuk, për pjesën tjetër nuk, nuk, nuk, do të thotë... është me rëndësi edhe kjo se edhe ne nuk kishim kumeditë shumë njohuri, sepse udhëhiqej, e thashë edhe niherë, edhe politika arsimore ka qenë e tillë që jo vetëm që të mos e duam Shqipërinë, pjesën tonë të atdheut, të mos e duam lirinë e Kosovës, të mos jepemi pas lirisë por ta urrejmë, ta urrejmë atë pjesë të atdheut. Ta urrejmë në emër të urrejtjes, kinse, në emër të leximit ose të Enver Hoxhës e tjera e tjera edhe atëherë.

Mirëpo, fati ka qenë i joni që librat që vishin ilegalisht nga Tirana, gjenin forma, gjenin mënyra. Po edhe ajo... televizioni mandej kur filloi të, të shihen emisione televizive edhe knej. Radio, mos të flas, kanë luftur ni rol të jashtëzakonshëm në ngritjen e vetëdijes dhe vetëdijësimin tonë atdhetar. Nga historia, po them edhe niherë, deri në vitin '68 kur osht' shënuar 500 vjetori i Skënderbeut nuk kemi mësuar shumë, veçmas para vitit 1966. Deri atëherë, do të thotë, ka qenë, ju e dini [Rankoviqi], ka qenë ni sistem i ashpër policor, ni sistem i dhunshëm policor jugosllav dhe njerëzit kanë shkuar në burg, jo vetëm për ndonjë veprim ose tjetër, por për ni fjalë goje ose për ni vizatim të vogël.

**Anita Susuri:** Gjatë demonstratave të '68-ës, a ju kujtohet edhe a keni qenë?

**Binak Ulaj:** Çka më kujtohet, do të thotë, unë nuk kam qenë në Prishtinë atëherë, kam qenë me ni fshat të rrethit të Pejës atëherë arsimtar. Por, por, atëherë kërkohet që, që të deklarohehim si punëtor të arsimit jemi apo i përprahim kërkesat apo s'i përprahim kërkesat e demonstratave. Për fat, po them edhe niherë, do të thotë, nëse mund të ketë sigurisht mund të jenë rujtur atëherë proces verbalët. Por, për këtë edhe ka shkruar në vazhdimësi për demonstratat, se atëherë si thuhet ktu, hidhej gurë e dru mbi kërkesat e demonstratave.

Për arsye se edhe strukturat qeveritare, politike shqiptare që ishin në qeverinë e atëherëshme të Kosovës e të Beogradit, për fat të keq kanë qenë si duket edhe nën trysnin e Beogradit, por edhe ndoshta të bindur se Jugosllavia është e përjetshme. Shumëkush mendonte që Jugosllavia nuk do të shkatërrohet kurrë. Madje edhe pas vdekjes të Titos thoshin, "Edhe pas Titos, Tito". Do të thotë, ishte ajo fryma, ishte ajo fryma e cila veçmas demonstratat e vitit 1968 i kthjellën mendjet e qytetarëve, ia kthjelloi mendjen.

Çka osht' me rëndësi u dha të kuptohet se e kanë ni forcë e cila do ta çlirojë Kosovën dhe këta jonë të ritë e të rejtat, osht' universiteti i Kosovës. Kjo kishte rëndësi të veçantë. U dha që qenka ni forcë e cila qenka në gjendje t'i kundërvihet ni sistemi çfare ishte sistemi shtypës i Beogradit. Po të them, unë atëherë kom qenë në burg, në '69-ten jam burgosë, më kanë burgosur. Mund ta merrni me mend në Burgun e Prishtinës edhe të burgosurit ordinerë që ishin, mos të them për vrasje, vrasjet e kishin ni dinjitet, e kishin ni karakter. Po edhe ata që ishin hajna, ndoshta hajna të thjeshtë, hajna të gjërave, të them edhe niherë kështu përpiqeshin, rrezikonin të na ndihmonin. U kriju ni besim te të ritë, te studentët, te pjesëmarrësit e demonstratave, ishte diçka e mrekullueshme.

**Anita Susuri:** Para se me vazhdu për burgosjen po më intereojnë këto vitet kur keni qenë student edhe kur keni marrë vendim me studiu në Prishtinë? Qysh kanë qenë qato vite edhe qysh keni marrë vendim për studime?

**Binak Ulaj:** Po, thanë të drejtën, pas kryerjes së shkollës së lartë në Prizren, unë kam punuar nja dy vite në arsim si ju thashë, në ni fshat të rrethit të Pejës, në Vrellë të Istogut. E pashë që, që nuk mjafton që t'i përkushtohem kryesisht, t'mbetem me atë përgatitjen shkollore dhe kisha dëshirë që... atëherë meqenëse u njohëm me ni grup tjetër të shokve, do të thotë, me të cilët ma vonë do e formojmë edhe grupin revolucionat të Kosovës. Me Zenel Ulaj, kushëririn tim, Xhafer Shatrin, me Idriz Zeqiraj, Idriz Dakën e kështu me radhë. Kam vlerësuar se roli im do të jetë, kontributi jem do të jetë Prishtina, aty ku ka studentë, ku ka të ri.

Lidhja me studentët, jeta bashkë me ta edhe bashkëveprimi me ta, aty e kam vendin, jo në ni fshat ose diku ku do e marrë vetëm një ditë. Kjo ka qenë arsyeja kryesore që unë e kam lanë punën atëherë me ni fshat atje në arsim dhe kam ardhë t'i vazhdoj studimet ktu [Prishtinë]. Ashtu fatbardhësisht ka ndodhur. Por, meqë ishim të ri edhe tepër entuziastë, do të thotë, në aksionin tonë për të shënuar përvjetorin tonë të parë të demonstratave i kemi shtypur afishet, i kemi shumëzuar, përgatitur, shtypur dhe shpërndarë. Si të ri që ishim duke mos pasur shumë, ndonjë edhe përvojë e tjera e tjera, ato kanë rënë në dorë të Sigurimit që ishte atëherë i alarmuar çdo përvjetor. Aq ma pak që ishte përvjetori i parë. Na kanë arrestuar, do të thotë, mrena pak ditësh.

**Anita Susuri:** A keni qenë t'u e zhvillu aktivitetin apo si?

**Binak Ulaj:** Jo, do të thotë, ata i kishin, ata i kishin gjetur në Universitetin e Prishtinës atëherë nëpër tavolina afishet. Për fat të keq, njanin e kanë zanë duke i shpërndarë ose kështu me radhë dhe pastaj kështu ka ndodhë do të thotë. Kush i ka themeluar, si i ka themeluar dhe kjo ka qenë ajo që kemi rënë shumë shpejt në duartë e tyre. Po kjo ishte e mrekullueshme. Pse e mrekullueshme? Nuk mund të mësohesh të notosh pa hy në ujë. Ishte ni shkollë, ishte ni përvojë që do të na shërbej pastaj shumë.

**Anita Susuri:** Ku keni qenë ju kur ju kanë arrestu?

**Binak Ulaj:** Kam qenë, unë pata gjetë punë ktu në shkollën, tash osht' Shkolla "Gjergj Fishta", atëherë quhej "Brasnilav Nushiq" te Taukbashçja. Aty kanë ardhë edhe më kanë marrë. Kjo ka qenë ni moment për mu, po them edhe niherë, vendimtar për, ndër më vendimtarë për përcaktimin e rrugës që do e vazhdoj ma tutje.

**Anita Susuri:** Ju kanë dërgu në Burgun e Prishtinës?

**Binak Ulaj:** Natyrisht.

**Anita Susuri:** Qysh ka qenë në atë kohë burgu?

**Binak Ulaj:** Atëherë të them të drejtën, çka të them për kushte, ju e keni pa ndoshta burgun tash. Kushtet kanë qenë, nuk janë, ky osht' transformuar shumë burgu. Atëherë nuk kemi pasë, nuk kemi pasur ushqim, por nga ato ma të randat nuk ishte ushqimi as kushtet në të cilat na vendosnin, po hetimet, malltretimet. Këto ishin ato që e vështirësonin jetën në burg. Megjithatë, po them edhe niherë ishte, ishte ni përvojë që mandej do të më shërbej. Atëherë kishim, nëse s'gabo, nga ni gjysë kilogrami bukë. Në mëngjes kishim ni lloj kafeje, siç e quanim atëherë prej elbit, elb i djegur e kështu me radhë. Po ajo që ishte ma, ma me peshë, po them edhe niherë, ishte fakti që malltretimet gjatë marrjes në pytje, zbulimi i shokëve, si ka ndodhë, kush, ku, e tjera e tjera, ato kanë qenë ma të vështira.

**Anita Susuri:** Sa kohë keni qëndru?

**Binak Ulaj:** Unë jam dënuar atëherë ni vit. Herën e parë, herën e parë, herën e parë. I kom mbajtur dikund tre muaj e diçka, pastaj na kanë liruar në gjykim se ka qenë ni lloj, kanë qenë të kategorizuar. Nëse dënohesh deri në pesë vjet, do të thotë mund të lirohesh të mbrohesh në liri. Kur më kanë liruar të mbrohem në liri, '70-ën, nuk më kanë thirrë ta vuaj dënimin ni kohë. Kam shkuar pastaj ushtar dhe është vjetëruar ftesa për dënim. Ka qenë nifare ligji që përshkruhej, nëse kalonte dyfishi i afatit të dënimit në periudhën sa je dënuar, kështu që i kam shpëtuar burgut të parë.

**Anita Susuri:** E në ushtri, a keni pasë pastaj ndonjë presion për shkak se keni qenë i dënumë?

**Binak Ulaj:** E tash, ta keni parasysh, veçmas të burgosurit politikë që shkonin ushtarë, ata kanë qenë të përcjellur në çdo hap. Ata e kanë pasë patjetër s'paku një i cili i ka përcjellë. Unë du të ju them këtë, ndoshta është edhe kjo me rëndësi të dihet, kam shërbyer në ni qendër në Vojvodinë, në Vršac përtej Beogradit është diku 82 kilometra. Ne si shqiptarë zakonisht bëheshim bashkë atje që ishim. Ndër ata që ishin bashkë me mu ushtarë aty ka qenë ni artist i Teatrit të Kosovës ktu, prej Tetovës ni Selim Ramadani. Ni artist, ka qenë ni djalë i jashtëzakonshëm, ni pamje që i ngjante, që i ngjante Aleksandër Mojsiut, pak me ni pamje të zeshtë, me do flokë kaçurrela. Shoqëroheshim bashkë aty.

Ni ditë e shoh që ishte tejmase i mërziur. I thom, "Selim, ç'ke?" Thotë, "S'jom mirë diçka me shëndet". Mu, e kisha mizën pas veshi mendoja pse. Thashë, "Po, shiko", thashë, "se nuk o çështje që po m'duket, trego nëse ke diçka", a din, "Unë", tha, "kam besim edhe do të tregoj. M'ë a thirrë", thotë, "përgjegjësi, shefi i shërbimit ushtarak dhe më ka thanë të të përcjellë". Thashë, "Për këtë je mërziur a?" Thashë, "Ti më tregon, çka tregon prej nesh, prej meje dhe ne të përgatitim çka t'i thush, mos u lodh për atë". Kështu ka ndodhë. Për fat, po them edhe niherë, jam përpjekë që të mos, mos të më zanë ku isha i vetëdijshëm në pozitën që isha.

Sado që, po them edhe niherë, atëherë ka qenë tjetër trajtim në krahasim me ata pas '81-shit, veçmas pas '89-ës kur fillunë t'i kthejnë në arkivole. Atëherë ka qenë megjithatë ma ndryshe. Ende nuk, nuk,

ose ndoshta ka ndodhë nuk e di që ka ndodhë, të kthejnë ndonjë ushtarë shqiptarë në arkivol. Por, ishte... megjithatë unë kam pasur tejmase kujdes, tejmase se e dija në çfarë gjendje jam.

**Anita Susuri:** Po, muj me thanë që edhe pas kësaj periudhës së Rankoviqit, ka qenë si ni lloj periudhe ndoshta ma e mirë pak...

**Binak Ulaj:** Ndëgjo, unë e dëgjova parmramë kur ishte perurimi i librit, jo flasin për këtë periudhë. Trajtimi i të burgosurve politikë ka qenë i njejtë, qëllimet e Beogradit kanë qenë të pandryshueshme, do të thotë, të pa ndryshueshme. Dhuna që osht' ushtruar ndaj të burgosurve, edhe pas '66-tes... '75-ën janë burgosur njerëzit, Baci Adem Demaçi osht' burgosë në '75-ën, sa kishte dalë nga burgu. Pa u zhvilluar asnjë aktivitet, po them kushtimisht, ende nuk kishin përfunduar vizitat në familje edhe e dënojnë 15 vjet.

Trajtimi ka qenë i njejtë, të burgosurit politik kanë pasë trajtim që ka qenë në kundërshtim me të gjitha normat ndërkombëtare, me normat ndërkombëtare të Kryqit të Kuq Ndërkombëtar, me Konventën për të Drejtat e Njeriut, me... se qeveria e Beogradit, veçmas Titoja. Na mahitem, [ai] ka qenë ni politikan që ka ditë të manipuloj, ka ditë të përfitoj nga interesat strategjike të fuqive të mëdha botërore. Të Rusisë njanën anë, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës nga ana tjetër, e më vonë edhe të Rusisë. Po veçmas të përfitoj edhe nga e ashtuquajtura si e ka pa themel, ndër themeluesit së bashku me kryetarit e Egjiptit, Naserin, Lëvizjen e ashtuquajtur të Painkuadruarve<sup>1</sup>, që s'janë as me lindjen as me perëndimin.

Mirëpo, politika ndaj të burgosurve politikë shqiptarë ka qenë gjithmonë e njehta, shtypëse, diskriminuese. Dhe për ma tepër, do të thotë, qëllimi kryesor ka qenë që të burgosurit politikë të thyhen moralisht, kjo ka qenë qëllimi i tyre. Për fat, po them edhe niherë, këtë nuk e kanë arritur. Nuk ka ndryshuar. Tash thotë dikush... '66-ën ka ndryshuar në ni masë politika, pas '74-tën kur osht' miratuar, është bërë Kosova pjesë përbërëse e federatës, po megjithatë mbeti nën kuadrin e Serbisë. Edhe '74-tën nuk u zgjidh çështja e Kosovës, se sa ishte e pavarur u dëshmu pastaj në vitin '99.

**Anita Susuri:** Ju më thatë që nuk e keni vazhdu ma burgimin, po mendoj nuk e keni mbajtur atë periudhë të caktume. Po a keni pasë të drejtë me vazhdu punën?

**Binak Ulaj:** E tash të ju them edhe niherë, pas burgut, pas dënimit të parë unë e kam vazhduar punën në ni kohë por jo të gjatë. Kam punuar në, kam filluar të punoj në arsim, në Kastriot, në Obiliq. Ka qenë vështirë, mirëpo gjindeshin lidhjet. Kishte njerëz që donin të ndihmonin, kta duhet pranuar. Nuk ishin krejt ashtu të anatemum prej çdo institucioni, prej çdo drejtori. Madje, dua t'ju them edhe këtë, le të

<sup>1</sup> Lëvizja e të Painkuadruarve (NAM), organizatë ndërkombëtare e përkushtuar për të përfaqësuar interesat dhe aspiratat e vendeve në zhvillim. Lëvizja e të Painkuadruarve u shfaq në kontekstin e valës së dekolonizimit që pasoi Luftën e Dytë Botërore. Lëvizja e të Painkuadruarve u themelua dhe mbajti konferencën e saj të parë (Konferenca e Beogradit) në vitin 1961 nën udhëheqjen e [Josip Bros Titos](#) të Jugosllavisë, [Gamal Abel Nasser](#) të Egjiptit, [Jawaharlal Nehru](#) të Indisë, [Kwame Nkrumah](#) të Ganës dhe [Sukarno](#) të Indonezisë.

jetë kjo meqë regjistrohet, edhe ata që punonin të gjithë në SUP<sup>2</sup> nuk kanë qenë shpirt-kriminelë. Në momente të caktuara edhe ndonjëri prej tyre, do të thotë, nuk ngulte kambë me çdo kusht, po e zamë, që të nxjerrë informatë prej teje ose që të shkatërroj fizikisht ose moralisht. Duhet pranuar këtë, nuk ishin të gjithë njisoj, këtë duhet pranuar. Duhet thanë sepse tregohemi jo real nëse thojmë se krejt ishin kriminelë, krejt ishin kështu, nuk qëndron ajo të lutem.

Tash, a kisha të drejtë? E gjetëm ni lidhje edhe unë hyra në punë aty. Por, meqenëse tani osht' fjala për, për vitin pas '73... m'u në atë kohë filloi po ashtu diferencimi dhe largimi nga puna e punëtorëve të arsimit, i punëtorëve të arsimit. Unë fillova të punoj aty në Kastriot, në Obiliq, në shkollën tetë-vjeçare. Jepja mësim në paralele serbe se njihja mirë serbishten. Sepse ishte ni periudhë atëherë '74-tën u bonën ndryshimet kushtetuese, plotësimet kushtetuese edhe serbët ishin të obliguar në mënyrë të mësojnë shqipen. Por, meqenëse kishin filluar veç, veç dyshimet e organeve të Beogradit kryesisht se rrjedhat e kërkesave e tjera të demonstratave '61 nuk janë shuar. Atëherë fillunë t'i largojnë punëtorët e arsimit të cilët kishin rënë ndesh me politikën zyrtare, përkatësisht që ishin dënuar t'i largojnë nga puna në arsim.

Gjatë asaj periudhe, do të thotë edhe mua do të më largojnë nga puna. Por, që të mos më lënë krejt pa punë, do të më thonë që të punoj në administratë. Gjatë punës që e kryja, s'ish kumeditë çfarë kumeditë administrate, po në të njëjtën shkollë, do të thotë arrestohem për herën e dytë. Po, atëherë ne, si thashë edhe niherë në vitin... pas daljes nga, kryerjes së shërbimit ushtarak, i konsoliduam radhët edhe e konsoliduam edhe formimin e grupit i cili kishte vepruar që nga vitin '68 e këndej, përkatësisht '69. Ni pjesë e këtij grupi në '74-tën do arrestohet edhe do të bie në burg. Në mesin e tyre edhe unë.

**Anita Susuri:** Domethonë, kur e keni formuar grupin, çfarë aktivitete keni marrë vendim me bo?

**Binak Ulaj:** Ndëgjo të lutem, do të thotë, grupi ka pasë statutin, e ka pasë programin, ka pasë... çka kemi bërë do të thotë? Qëllimi jonë ka qenë... cili ka qenë kryesor ka qenë? Programi për vetëdijësimin e masave se Kosova, megjithatë është e pushtuar, se Kosova duhej të mendoj, se populli i Kosovës duhej të mendoj të çlirohet një ditë, se e vetmja zgjidhje e jona është çlirimi i Kosovës dhe bashkimi me Shqipërinë. Sepse, ju si të reja, poqëse do të ishim bashkë me Shqipërinë mund ta merrni me mend, do të ishim ni shtet i konsoliduar në Ballkan, ni shtet i fortë në Ballkan, edhe për nga numri i popullsisë po edhe nga potenciali ekonomik, nga pasuritë natyrore.

Merreni me mend, shembull po e marr, Shqipëria ka bregdet, Kosova ishte në nifare mënyre hambari i Shqipërisë. Lignit 80-50 përqind të rezervave të lignitit i ka pasë po e zamë Kosova, Trepça, e kështu me radhë. Çka do të thotë? Ishte vetëdijësim, i se tash po e shfrytëzoj rastin të them edhe niherë, në Shqipëri ni pjesë e popullsisë, në atë krah, shqiptartë e atij krahut do të thotë, të Shqipërisë shtetërore,

<sup>2</sup> Sekretarijat Unutrašnjih Poslova (SUP) - Sekretariati i Punëve të Brendshme që në kohën e RSFJ-së ka qenë emërtim për policinë.

nuk e kanë shumë të qartë thojnë, “Po ju i keni pasë kushtet. Keni pasë traktorë, keni pasë makinë”. Ishte e vërtetë që i kishim kushtet, ndoshta ekonomike, gjendjen ekonomike ma të mirë se ata, por ishim të diskriminuar në krahasim me popuj tjerë, të lutem, Ishim të diskriminuar.

Ndërsa Jugosllavia mesatarisht, do të thotë, Kosova kishte qenë meniherë pas Luftës së Dytë, meniherë e dyta, 50 përqind ma e pa zhvilluar se mesatarja jugosllave. Me kalimin e viteve u bo tri herë ma e pa zhvilluar, jo gjysën. Përveç asaj, do të thotë, përveç asaj ndjenjës që ne e ndjenim, do të thotë, që ne jemi qytetarë jo të barabartë me qytetarë tjerë. E ndjenim që ne patjetër duhet të jemi të lirë, mos të na ndikojë... mund ta merrni me mend, po e zamë 80 përqind e kishim vende udhëheqëse serbe, 80 përqind banesa, e tjerë e tjerë.

Në këtë, rol vendimtar kanë pasë, dua të them edhe këtë ju ta keni parasysh si të reja, se keni parasysh roli i nanës shqiptare, i prindërve. Nana i lindi pesë, gjashtë, tetë kështu me radhë dhe numerikisht nanën shqiptare e mundën, e mundën... roli, faktori demografik pati ni rol vendimtar. Se thoshim, “Po mirë, ju i keni 80 përqind të vendeve të punës e jeni dhetë përqind serbë, si ndodhë kjo?” Do të thotë, ishin kërkesa e tjera e tjera.

Megjithatë, në nifarë mënyre po them edhe niherë, nganjëherë ka ktu moskuptime me ni pjesë të bashkëatdhetarëve tanë. Këtë të Shqipërisë shtetërore nuk e kanë shumë të qartë ata. Ata mendojnë se ne osht’ dashtë të jemi të kënaqur me ato kushte dhe me atë sistem. Ne s’mund të ishim, për arsye se, po e thom edhe niherë, se ishim edhe kur u bonën ndryshimet kushtetuese në ‘74-tën u avancu pozita e Kosovës, por ne përsëri mbetëm nën Serbi edhe nën Jugosllavi.

## Pjesa e Tretë

**Anita Susuri:** Cilat kanë qenë për shembull, me më tregu për hartimin ndoshta të traktateve të ndryshme apo ku jonë shpërnda këto, te kush?

**Binak Ulaj:** Ndoshta, ndoshta e, e tejkalova këta. Do të thotë një ndër format për vetëdijësimin e masave ishte hartimi, shkrimi, shtypja dhe shpërndarja e afisheve, e traktateve, ku theksoheshin kryesisht ato çështjet të cilat ishin me rëndësi për Kosovën: shfrytëzimi i ekonomisë të Kosovës nga Beogradi, keqtrajtimet, e mos të flas për të drejtën e vetëvendosjes e tjera, e tjera. Ato ishin pjesë e programit të veprimtarisë, përveç tjerat afisjet. Programet, organizimi i debateve, shqyrtimi i çështjeve të përbashkëta, i formës së organizimit e kështu me radhë. Këto të gjitha kanë qenë të përcaktuara me program.

**Anita Susuri:** E te programi, për shembull, kush e ka hartu ose a keni hartu ju si grup apo ka qenë ma shumë...

**Binak Ulaj:** Natyrisht, si grup. Jo, jo, e kemi hartuar si grup. E në këtë grup kanë qenë, thashë edhe ni herë nuk e di a, ne kemi qenë të organizuar sipas të ashtuquajtur formulë e treshit. Ne tre e formojmë një grup, një celulë, ti e formon ni treshe tjetër, kjo ni treshe tjetër, dhe kështu bohet ni lloj rritje do thosha shumë interesante. Dhe në qoftë se po e zamë zbulohemi ne tre, unë i zbuloj po e zamë dy ose, po një herë do shkëputet se ndonjeri nuk do i zbulojë, do të shkëputet ajo dhe kjo arriti të funksionojë. Mos t'i bie kjo se unë po e lavdoj këtë grup, po ka qenë fat i tij kur kem ra në '74-ën në brug, asnjëri prej veprimtarëve të grupit nuk i ka zbuluar grupet tjera. Përveç asaj, ky grup është grupi i parë i cili e ka nxjerrë organin e vetë të shtypit, "Zërin e Kosovës", une besoj që keni dëgjuar.

Numrin 1 dhe 2 e kam përgatitur... numrin 1 e 2 i kemi përgatitur bashkë me Xhafer Shatrin, Mehmet Hajrizin, [Hydajet Hysenin](#), Kadri Osmanin, dhe numri 3 na është zanë prej policisë. Mandej ata, meqë nuk kanë ra në burg edhe ata, do të thotë kanë vazhdu ta nxjerrin edhe disa numra. Më pas, "Zëri i Kosovës" ka vazhduar të botohet jashtë.

**Anita Susuri:** Si ka ndodhë kjo, thatë që fillimit disa pjestarë tjerë politik janë burgosë, po deri te ju qysh ka ardhë? Sigurisht...

**Binak Ulaj:** Jo, thashë edhe ni herë, do të thotë gjatë aktiviteteve, veprimtarisë. Do të thotë, ka qenë e pamundun se ka qenë përcjellje shumë e madhe, ndonjeri të mos zinet. Dhe ne që tash ishim në listë atje, unë jam burgosur me datën 5 maj, '74-tën për herë të dytë. Jam burgosur në shtëpinë e Kadri Osmanit, gjatë kohës kur i kom bartur makinën e shkrimit dhe letrat nga një bazë që e kishim në rrethin e Pejës atje për t'i sjellë në Prishtinë. Na kanë përcjellë. Dhe meqenëse përpara kanë qenë të dënuar bashkë me ne Xhafer Shatri, Jashar Alia, atëherë do të thotë ata i kanë marrë meniherë ata me të cilët kemi qenë të dënuar, pavarësisht a i kanë zanë apo s'i kanë zanë. Po, po them edhe ni herë, për fat do të thotë në '74-ën, përveç ne të pesëve nuk u zbulua ndonji, nuk u arrestu tjetër kush dhe ne nuk i zbuluam tjerët.

Mandej në '75-ën i kanë marrë kriter e pa kriter. E thashë, e përmëna rastin e bacës Adem, do të thotë e marrin, njeri sa kish dalë prej burgut. Nuk kishim arritë as të bisedojmë, kishim biseduar po nuk kishim arritur tash të bisedojmë çka do bëjmë. Mund ta merrni me mend.

**Anita Susuri:** Juve ju kanë dërgu sigurisht prapë në Burgun e Prishtinës, pasi keni qenë këtu veç.

**Binak Ulaj:** Në Burgun e Prishtinës kom nejtë dikun 13 muaj në vetmi, pastaj na kanë dërguar në burgun e Mitrovicës dhe mbrapa në burgun e Pejës, dhe prej aty në burgun e Mitrovicës së Sremit.

**Anita Susuri:** Sa vite jeni, po menoj jeni dënu si grup sigurisht.

**Binak Ulaj:** Urdhno?

**Anita Susuri:** Ju sigurisht jeni dënu si grup?

**Binak Ulaj:** Po. Jom dënu do të thotë në vitin '75, se në '74-ën jom burgosur, në '75 jom dënuar, do të thotë kemi nejtë ni vit e ma tepër nën hetime. '75-ën jemi dënuar pesë vjet.

**Anita Susuri:** Pesë vite. A ka qenë ky dënimi maksimal në grup, apo ka pasë...?

**Binak Ulaj:** Jo, ka pasë. Kadriu është dënuar nëntë vjet, Xhaferi është dënuar tetë, une pesë, Jashari është dënuar katër, Jashar Alia, dhe Metë Shatri [5:08] tri.

**Anita Susuri:** E gjatë kësaj kohe ju sa keni qenë nën hetime, çfarë të drejta keni pasë ose...

**Binak Ulaj:** Çfarë...?

**Anita Susuri:** Çfarë të drejta keni pasë si i burgosuar ose kush ka qenë qaj...

**Binak Ulaj:** Aha. E thashë edhe ni herë do të thotë, mirë që ma kujtove. Nuk ke pasë, gjatë hetimeve nuk ke pasë të drejta, as të drejtat ma minimale do të thotë. Nuk ke pasë të drejtën në shtyp, nuk ke pasë të drejtën ni libër të lexosh, mos të flas për tjera. I ke pasë vizitat e caktuara. Dhe lufta jonë kryesore ka qenë lufta për njohjen e statusit të burgosurit politik. Ne nuk na njihej statusi, e drejta e statusit të burgosurit politik. Ne thjeshtë trajtoheshim si...

**Anita Susuri:** Irredentist ndoshta.

**Binak Ulaj:** Jo vetëm irredentist, irredentist ai që dëshiron të bashkojë ni pjesë tjetrën, po trajtoheshim sikur, si armiqë të sistemit, armiqë thjeshtë, mos të them si kriminelë. Bile, shpesh ndodhte të na quajnë kriminelë se, "Nuk jeni të burgosur politikë".

*[Këtu ndërprehet intervista]*

**Anita Susuri:** Zoti Binak, ishim t'u bisedu për pjesën e dytë, me thonë, të burgosjes, herën e dytë që jeni burgosë. Mirëpo, para se me vazhdu aty, ju ndërkohë më tregutë ni histori të familjes, të persekimit që po doni me ndërlidhë.

**Binak Ulaj:** E përsëris edhe ni herë do të thotë, dallime në trajtimin e të përndjekurve e të burgosurve politikë pavarësisht periudhave, do të thotë ka qenë dallim, ka qenë trajtim, trajtim i cili në kundërshtim jo vetëm me normat ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Ndonëse Beogradi ka qenë nënshkruar edhe i Deklaratës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, edhe i Kryqit të Kuq Nderkombëtar, edhe anëtar i Helsinki Watch edhe kështu me radhë. Po ai asnjëherë, do të thotë, i ka nënshkruar formalisht.

Veçmas ndaj të burgosurve politikë shqiptar që ka pasë ma së shumti të burgosur politikë ne ish Jugosllavi. Duke mos e llogaritë periudhën e Infobirosë<sup>3</sup>, do të thotë nuk ka pasë burg që nuk [ka pasë] shqip[tarë] në ish Jugosllavi, veçmas burgje të mëdha, që s'ka pasë shqiptarë. Dhe trajtimi ka qenë po ashtu, po them edhe ni herë, ka qenë tejmasë i egër, i ashpër, brutal, dhe ka qenë, faktikisht ka qenë rrënjimtar për shëndetin e shumë të burgosurve që e kanë humbë jetën edhe nëpër burgje. Ju e dini që në brug është mytë Riza Grajqevci, Shaban Shala, Zija Shemsiu është mytë në Burgun e Beogradit e kështu me radhë.

Dhe tani të kthehem edhe te, te një, një periudhë tjetër ose do thosha edhe një herë te një, do e quaja ma tepër te një trajtim jo vetëm ne që ishim të burgosur, po edhe persekutimi i familjarëve të ish të përndjekurve dhe të burgosurve politikë. Për mu nashta ka qenë periudha ma e randë sesa ato të burgjeve. Fakti kur, pas pezullimit të qasaj gjysë auto... gjysëm autonomie që kishte Kosova në vitin, 23 mars të vitit 1989, ishte persek... jo vetëm largimi nga puna por ishte edhe marrja e banesës, nxjerra me dhunë nga banesa të cilën e kisha marrë në mënyrë te ligjshme.

Dhe unë atë banesën në të cilën kam qenë kom qenë, banesë familjare, e kom marrë nga Enti për Sigurim Pensional Invalidor ku kom gjetë punë, pasi që ni kohë m'u ka ndaluar puna në arsim. Dhe ç'është e keqja edhe më e madhe, do të thotë këtë banesë ia japin shqiptares juriste, edhe burrin e ka jursit, shqiptar. Shqiptarës e cila kishte mbetë të punojë me organe të dhunshme, të cilës baba i ka lanë shtëpi trashëgim. Dhe në vitin 1996, policia më nxjerrë me dhunë mu edhe familjen time.

Ky ka qenë momenti ma i randë për mu edhe familjen time, për arsye se atëherë e kisha nanën në moshë dhe fëmijët katër, prej moshës dy deri në moshën dhjetë vjeçare. Atë kohë isha edhe unë pa punë edhe shoqja pa punë, të cilët na kishin nxjerrë se kishin larguar nga puna afër njëqind mijë punëtorë. Po them edhe ni herë, ky ishte ni veprim i organit të dhunshëm serb, i cili kishte planifikuar me siguri se ne tani edhe, ky veprim i tyre do t'shkaktojë edhe ndonjë konflikt mes nesh.

*[Këtu ndërpritet intervista]*

**Binak Ulaj:** Nuk kom ra në atë farë, në atë farë grackën, nuk i kam lejuar vetës, as nuk i kom lejuar vetës që këtë çështje ta zgjidhi në mënyrë jo të ligjshme. Une i jom drejtu gjyqit edhe pas luftës, po për fat të keq siç e dini, do të thotë në Kosovë me insistimin e faktorit ndërkombëtar, UNMIK-ut, e kështu me radhë, do të thotë në Kosovë vazhdoi zbatimi i atyre ligjeve, ligjeve të cilat i kish sjellë Serbia në kohën e okupimit klasik të Kosovës pas 1989-ës. Ky ka qenë momenti ma i randë për mu, do të thotë {psherëtinë} kur i kom pa nanën plakë edhe fëmijët, si ju thashë edhe ni herë, të moshës, prej moshës prej dy deri në moshën dhjetë vjeçare para banesës aty duke na nxjerrë policia me dhunë.

<sup>3</sup> Rezoluta e Infobyrosë në vitin 1948 ishte vendim i Kominformit për të dëbuar Partisë Komuniste të Jugosllavisë. Pas kësaj, ata që dyshoheshin se kishin simpati ndaj Moskës, në Jugosllavi përndjekeshin si kominformistë.

Po ma e randë ishte ajo që këtë banesë e pranoi çifti shqiptar që ishte jurist, edhe të cilët me siguri tash janë dikun në institucionet tona edhe nuk, nuk e di a i brenë ndërgjegja fare, a s'i brenë ndërgjegja. Kjo ishte njëra ndër ato format të cilat do të thotë se Organet e Sigurimit, veçmas serbe, po edhe ato që ishin shqiptare në shërbim të tyre, do të thotë na bonin presione, shantazhe të ndryshme. Në forma të ndryshme duke, do të thotë i përndjekur, malltretuar, keqtrajtuar edhe familjarët tanë. Se ne si individë në fund të fundit ishim të përgatitur në një masë, ishim të vendosur edhe e dishim se çka na pret në qoftë se, se do binim përsëri ose në duartë e Organeve të Sigurimit.

Po përkundër të gjitha këtyre, do të thotë, ku qëndron madhështia e ish të përndjekurve politikë, do të thotë qëndron madhështia se ata përkundër kësaj, ju lutem, nuk hiqnin dorë nga veprimtaria. Edhe pse e dinim se nesër mund të zbulohen, sepse ju thashë edhe ma përpara, ish Jugosllavia ka qenë shtet policor, ka pasë një Sigurim për të cilin ka investuar tejmase shumë, ka pasë bashkëpunëtorë të shumtë, dhe e dinim se nesër, pasnesër do zbuloheshim. Por, përkundër kësaj që e dinim se do kalojmë në, do thosha nëpër tortura të tilla, nëpër një golgotë të tillë, ne nuk jemi tërhequr, nuk na është thyer morali, nuk e kemi hupë besimin në idealin e ilirisë.

**Anita Susuri:** Ishim edhe t'u folë për burgun, tregutë që në herën e dytë që jeni burgosë keni qenë në Burg të Prishtinës, pastaj në Mitrovicë, pastaj në Mitrovicën e Sremit.

**Binak Ulaj:** Po, shif të lutem, do të thotë në burg hetues kom qenë 13 muaj këtu në vetmi në Prishtinë, mandej në Mitrovicë. Trajtimi në Mitrovicë po ashtu ka qenë shumë çnjerëzor. Është varë nganjëherë, në atë periudhë kur kom qenë unë në viti '75, shumë edhe nga drejtori i burgut. Në Mitrovicë ka qenë ni drejtor i cili ka qenë jo vetëm, jo vetëm pro jugosllav, po ka qenë kundër-shqiptar i përbetuar. Ai u jepte, merre me mend, gardianëve të drejtë që të na malltretojnë. Madje edhe rojtari kur na rruante ka ni here në javë, domethonë e përdorte një brisk rroje për 30 vetë, 40 vetë, saqë ndodhte p'e zamë edhe gjaku të na del ftyrës. E ai ishte serb.

Për kushte nuk po flas. E aty na mungonte, sidomos gjatë periudhës së verës, më muajin korrik edhe gusht, se nuk ka dritare, dritaret janë të mbyllura me nifarë mënyre {shpjegon me duar renditjen e xhamit} që mos të mund shohësh jashtë, as ni metër jashtë dritareve, ashtu që veç me, në ni mënyrë të vendosur pjestë pjerrtaz, në formë të pllakave të betonit ku nuk depërtonte as ajri sa duhet. Po për kushtet, kanë qenë po them edhe ni herë, edhe kushtet fizike në burg të tmerrshme. Trajtimi ka qenë i tmerrshëm. Ka qenë ni trajtim edhe tepër poshtrues. Mund ta merrni me mend, po e zamë, sa herë na e binin drekën, pa kaluar dy-tre minuta na e kërkonin që t'i dorëzojmë ato porcia që i kishim. Ose, kjo nuk është diçka për të ardhur keq të them. Edhe në banjo kur na çonin, tre-katër minuta, "Dilni, dilni, dilni!" Pa... ne ishim pesë-gjashtë vetë, shtatë në dhomë e tjera, e tjera.

Ishte e tmerrshme, ishte e randë, ishte, ishte një lloj, një lloj i ofendimit i skajshëm do të thotë i dinjitetit tonë. Megjithatë, po them edhe ni herë, fatbardhësisht ne e kemi rujtë atë dinjitet, nuk, as nuk revoltuoheshim në atë kuptimin që të reagojmë në mënyrë të shfrenuar. Çdo herë reagonim me

shkrime dhe kur... me grevë urie. Do të thotë, kemi gjetë forma të cilat vareshin nga ne. Jo të bajmë veprime të cilat mund të na, të na kushtonin pasaj edhe me tortura të randa shtesë fizike. Përndryshe edhe në Pejë pastaj kom qenë në burg nga Mitrovica, dhe në Pejë falë, duhet thanë edhe këta, drejtorit të atëhershëm, Ekremit, Kryeziut, vendasit tënd [i adresohet kameraperonit], e kemi pasë një trajtim shumë ma të përshtatshëm, shume ma tolerant. Ndonëse edhe atje kam qenë në vetmi.

Po vetmia nganjëherë është, thonë, “Kaniherë nuk është i randë burgu, sa janë të randë të burgosurit”, sepse ne, do të thotë meqenëse nuk kishim trajtim, do të thotë kishim trajtim të veçantë për të keq, po nuk na njihej statusi i të burgosurit politikë, prandaj na bashkonin me të burgosur tjerë, me të burgosur ordinerë. Nuk po flas, se ata që kanë qenë të bugosur për vrasje, megjithatë e kishin një... po me hajna, me dhunues e tjera, kjo ka qenë tejmase randë. Madje, nëpër të ashtuquajturat shtëpi korrektuese, ndëshkuese, korrektuese si i quanin, atje kemi qenë në dhoma kolektive me 30, 40 edhe ma shumë. Atje ka qenë, përveç hajnave ose dhunuese, atje ka pasë edhe njerëz që kanë qenë me probleme shëndetësore psiqike, dhe këto kanë qenë të randa, po them edhe ni herë vërtetë shumë të randa. Më kujtohet në Mitrovicë të Sremit ka qenë, ka pasë raste të tilla.

Pastaj prej Mitrovicës së Sremit, se ju thashë edhe ni herë e vetmja formë që ne do të thotë reagonim, ishte forma me shkrim drejtuar organeve shtetërore, po edhe greva e urisë. Pas Helsinkit, komitetit, mbledhjes së Helsinkit në ‘75-ën, ju thashë para se Titoja ka qenë, p’e përdori ni shprehje kështu, ka qenë stërkopil, stërkopil. Ai meniherë e organizon mbajtjen pas Helsnikit, në Beograd në vitin ‘77 dhe ne organizuam grevë meqenëse vinin burrshtetas nga Evropa, nga shumë shtete nënshkruese të Deklaratës së Helsinkit, për t’i treguar se ka të burgosur shqiptarë, politikë shqiptarë për arsye se nuk na njihej ky status.

Dhe pasi e kem filluar grevën, na kanë transferuar nga aty në burgun e Idrizovës. Në krahasim me burgun e Mitrovicës, burgu i Idrizovës ka qenë ni burg, nuk e di çfare kanë qenë burgjet në Afrikën e Jugut, po i marrë si shembull, ose ndoni shtet tjetër të Afrikës ose, kanë qenë vërtetë shume ma të tmerrshme, shumë ma të padurueshme. Sjellja e gardianëve dhe e personelit të burgut në Idrizovë ka qenë jashtë çdo norme edhe, jo mo ligjore po njerëzore. Për këtë arsye edhe atje kemi bërë grevë. Fatbardhësisht aty kom hasë në shokë të cilët nuk i kisha takuar ma parë, ndonëse kishim vepruar në të njejtën organizatë, në të njejtën lëvizje, në të njejtin grup i cili kishte shumë degë. Rexhep Malën, Rafi Halilin nga Tetova, Gafur Lokun nga Kaçaniku, Njazi Korçën nga Gjilani, Hasan Dërmaku po ashtu nga Gjilani, e kështu me radhë.

Por është me rëndësi t’ju them edhe diçka dhe duhet mbajtur mend, ta keni, jo për t’u lavdruar, të burgosurit politikë shqiptarë kanë qenë shembull për përkrahjen e njëri-tjetrit, për solidaritetin me njëri-tejtrin. Në qoftë se, cilido prej të burgosurve politikë është dënuar me vetmi, ne kemi reguar të gjithë tjerët. Kemi kërku që të gjithë të na dërgojnë nëpër vetmi. Në qoftë se, ndonjenin e kanë malltretuar, po ashtu kemi reguar, nuk kemi nejtë duarkryq, ato ishin mundësitë tona. Për shkak të organizimit të grevës dhe trajtimit çnjerëzor në burgun e Idrizovës, dhe organizimin e grevës për të na

njohur statusin e të burgosurit politik, edhe prej atyhit do t'më largojnë edhe mua, Njaziun, Rexhep Malën, Njazi Korçën, Rexhep Malën. Njaziun do e dërgojnë në burgun e Mitrovicës ku kom qenë unë, Rexhepin do e dërgojnë në burgun e Spuzhit në Podgoricë, ndërsa mua do të më çojnë në Zenicë.

Kjo ishte pak, një lloj përshkrimi në vija të trasha. Të them të drejtën, në Zenicë trajtimi i të burgosurve politikë ka qenë po ashtu i vështirë për atë arsye se ata punonin në hekurarin, i Zenicës, në Kombinatin Metalurgjik të Zenicës, besoj keni ndëgju, është kombinat gjigand sikurse kombinati i Trepçës, po në përmasa shumë ma të mëdhaja, ku bahej shkrirja e legurave, jo e metaleve. Legurat janë metale të shkrira, pastaj që derdheshin nëpër kallupe, po për t'u mos u ngjitë figuracionet, për t'u mos u ngjitë në kallup, kallupi shtrihej me pluhur të qymyrit. Ata që punonin aty, do të thotë, shtatë orë, tetë orë, baheshin fare të zi prej bloze, vetëm syzat që i kishin, kur i hiqnin, i kishin do të thotë të pambuluara me, me, me... për fat, për t'iu shmangur kësaj, ni pjesë kishin deklaruar që të shkojnë në shkollë dhe ata që shkonin në shkolla, zanate natyrisht, jo shkollë kështu, do të thotë punonin katër orë, dhe katër orë shkonin shkollë për ta lehtësuar pak barrën.

Kështu që, po them edhe ni herë, ishin, lufta jonë kryesore ka qenë një, ruajtja e shëndetit, solidariteti me shokë, po edhe në burg kemi lexuar, kemi shpërndarë literaturë, jemi informuar për rrjedhat jashtë vendit. Madje, ka pasë raste kur prej burgut të Idrizovës, Rexhep Mala shembull p'e marr që ka qenë njëri prej veprimtarëve ma të dalluar të lëvizjes ilegale, të cilën po ashtu kom pasur fatin ta njoh, për fat të keq pastaj u vra në Kodrën e Trimave këtu bashkë me Nuhi Berishën. Prej burgut ata kanë organizuar takimin e shokëve dhe të grupeve të cilit i takonin, do të thotë edhe atje. Edhe atje ka arritë të sigurojë tranzistor. Por, ajo që vlenë të theksohet, po e përsëris, ka qenë përkrahja e njëri-tjetrit, solidariteti me njëri-tjetrin. Kur kemi hy në grevë, kemi hy të gjithë. Dhe për atë arsye, do të thotë, na kanë shpërndarë edhe prej atyhit. Më në fund pas pesë vitesh, së fundit do të thotë kam dalë prej burgut në '79-ën, nga burgu i Zenicës.

**Anita Susuri:** Keni dalë atë, domethonë atë ditë që është caktu apo...

**Binak Ulaj:** Aq sa isha, sa ish caktuar. Për ma tepër, kur jemi dënuar në '74-ën, për fat, për fat, drejtori ka qenë ni drejtor boshnjak i burgut të Zenicës, na i dhanë aktgjykimet dhe aktakuzat. Aktakuzat dhe aktgjykimet, se përndryshe shumë kujt nuk i jepshin. E përmena këtë ta keni parasysh edhe diçka ka peshë, duhet patjetër një ekip juristësh t'i analizojë këto aktgjykime dhe të sheh absurditetin e arsyeshmërisë juridike të këtyre aktgjykimeve. E në qoftë se, ne kemi qenë një herë të dënuar po jemi takuar pas burgut, sikurse tani që pijmë kafe bashkë, Organet e Sigurimit do të thonë se janë takuar, shembull p'e marr, dhe ekziston dyshim i bazuar, kjo ka qenë arsyetimi, se ata kanë folë për çështje të organizimit, për gjendjen e tjera. Mund ta merrni me mend!

*[Këtu ndërprehet intervista]*

**Binak Ulaj:** Thashë edhe një herë, kjo ka qenë me rëndësi. Studimi i arsyeshmërisë juridike të aktgjykimeve në të cilat nuk ekzistojnë, nuk arsyetohen me fakte, me vepra të faktuara. Por, për ta mjaftonte dyshimi i bazuar, ekziston thotë dyshimi i bazuar se filani është takuar me filanin ose filanin, dhe ekziston, ekziston dyshim, kanë biseduar. Prandaj po them edhe ni here, është detyrë, detyrë e, e, edhe e jona si Shoqatë e të Burgosurve Politikë, por edhe e institucioneve që edhe ky aspekt juridik i aktgjykimeve të zbardhet edhe të ndriçohet. Ka peshë, ka peshë sidomos për, për ndërkombëtarët, veçmas për Evropën edhe Shtetet e Bashkuara, me pa se si arsyetohej ni aktgjykim ku thuhet p’e zamë se filani është takuar me filanin dhe kanë biseduar p’e zamë ose, prandaj në bazë të saj ekzistojnë dyshimet se, e tjera e tjera.

**Anita Susuri:** E pas kësaj daljes, a keni vazhdu me aktivitete?

**Binak Ulaj:** Pas daljes nga burgu nuk jam angazhuar në aktivitete në kuptimin e maparshëm. Lëvizja Kombëtare kishte avancuar atëhere, kishte avancuar. Ekzistonin pastaj forma tjera të, të veprimtarisë, do thosha ma tepër gjysëm ilegale, ndonëse kishte edhe ilegale, veçmas Lëvizja për Çlirimin e Kosovës që e nxirrte “Lirinë” atëhere, revistën, “Çlirimi” desha të them. Dhe ishte momenti kur duhej të vendosja edhe këtë. Duhet të vendosja të krijoj familje apo jo, se kom dalë në moshën 34 vjeçare dhe ish momenti i fundit. Prandaj jam përcaktuar se çështja e Kosovës, une e konsideroja, nuk është çështje e lëvizjes kombëtare, nuk është një çështje që do të thotë varet personalisht nga unë po do të thotë kësaj lëvizje mund t’i kontriboja edhe në forma tjera. Po do i kontriboja edhe me formimin e familjes, me krijimin e një familjeje të shnohtë me fëmijë të edukuar dhe kështu e vlerësoja.

Ndonëse nuk kom bërë do të thotë aktivitete sikurse më parë në ilegale. I jam kthyer punës në, në, në arsim, meqë nuk m’u ka lejuar atëherë kam punuar në administratë. Megjithatë, më duhet ta them edhe këtë, në forma të ndryshme do të thotë, jam përpjekur që, jam përpjekur, e kam dhanë ndihmesën time në ato forma që jom i lejuar do të thotë. Kam ndihmuar... meqenëse isha, të thom edhe ni herë me ni pjesë afër kufirit, përcjelljen e shokëve për Shqipëri për të na sjellë edhe informatat si të veprojmë, edhe literaturë, po ka ndodhë që edhe ndonjeni që ka qenë i rrezikuar do të thotë, e kom nxjerrë anena në mënyrë që të mos bie në Organet e Sigurimit.

Ka qenë ni fakt i hidhur, se disa momente para se, me 12 janar, ‘80 e... viti ‘84, do të thotë mund të mos, ndoshta s’jom i sigurtë momentalisht se është gjatë do të thotë, për pak kom qenë, kom pasë mundësi që t’i, t’i nxjerrë edhe Rexhep Malën e Nuhi Berishën. Por si thuhet te ne, nganjëherë fati jonë është ai që i pamundëson gjërat ose ia ndërron rrjedhat. E kom pasë për detyrë, e kom marrë si detyrë t’i nxjerrë anena, por pasi ia kam siguruar në Vuthaj atje në vendlindje një vendstrehim deri në pranverë se ishte janari, do të thotë ata veç, në përballje me policinë do të thotë janë vrarë.

**Anita Susuri:** E qysh i keni ndihmu, qysh keni bo këtë dalje?

**Binak Ulaj:** Po ndëgjo tash, unë ju thashë edhe ni herë, unë jam një, një adhurues tejmasë i natyrës, kam kalu ni pjesë të madhe të jetës në ato bjeshkë dhe ato shtigje, i njoh jashtëzakonisht mirë do të thotë. Edhe sikur të lëshohej gjysa e, e, po e, po e boj pak, po e hiperbolizoj do të thotë, e armatës ose e kufitarëve të postës që ishte në Vuthaj aty, nuk mund të më zinin, për arsye se disha shtigje dhe shtigje. Përveç asaj, unë i përcjellja lëvizjen e patrollave të policisë, të ushtrisë kufitare në raste të tilla, me vite të tëra, ka shkojnë, ku ndalen, e tjera, e tjera.

**Anita Susuri:** Po, po më intereson, e përmendët edhe formimin e familjes. A ka qenë e vështirë për juve si ish i burgosur me e gjetë për shembull ni shoqe, ose me qenë i paragjykim prej shoqnisë ma të gjanë?

**Binak Ulaj:** Ndëgjo, duhet t'ju them, prej atyre familjeve atdhetare, ne kemi qenë të vlerësuar. Kemi qenë të vlerësuar edhe prej popullit, prej shumicës kuptohet, përveç atyre që ishin thjeshtë me shpirt pro-Jugosllav. Dhe ka qenë e vështirë, duhet, nuk është kjo, po është mirë ta dini. Unë e kom motrën e një shoku me të cilin kom qenë në burg. Dhe meqenëse familjet tona, familjet e të përndjekurve dhe të burgosurve politikë shkonin në burgje për t'i vizituar familjarët e tyre, takoheshin, njiheshin. Edhe ato do krijojnë një miqësi në mes vete, edhe ato do të afrohen me njëra-tjetrën. Dhe ky afrim, kjo miqësi, do e krijojë një kategori të shoqërisë sonë e cila do t'i bëjë ballë presionit, shtypjes, edhe shtantazhit të Organeve të Sigurimit.

Kështu që, unë e kom do të thotë motrën e një shokut. Dhe të theksoj këtë, këto familje, pa përkrahjen e familjarëve, pa përkrahjen e familjeve, prindërve, motrave, vëllezërve, po edhe bashkëshortëve, lëvizja nuk do ecte përpara, nuk do avanconte. Ishte, do ishte e pamundur. Roli i familjeve ka qenë ndër faktorët vendimtarë. Dhe ne, edhe ni si të burgosur, për fat të keq nuk kemi dalë borxhit nanave tona, motrave, veçmas grave tona, të cilat ka pasë rast, shembull p'e marr shokët e mi, Rexhep Mala, pasi osht' martu disa muaj ka rënë në burg, e ka pritë e shoqja tërë jetën. Xhafer Shatri, dy javë, tri javë pasi ka rënë në burg, e ka pritë edhe pse është dënu nëntë vjet, në të vërtetë është dënu në '74-ën, tetë, pastaj është ridënuar përsëri në burg edhe tri vjet e gjysë, e ka pritë.

Ishte një, po them edhe ni herë, diçka që duhet vlerësuar kjo për, për bashkëshortet tona, për nënat tona, për motrat tona. Duhet vlerësuar, duhet ta kemi. Për fat të keq pak kemi shkruar për këtë dhe duhet, duhet ta kemi parasysh t'ua kthejmë bile një pjesë të borxhit. Dhe kjo besoj duhet të jetë shembull edhe për ju që jeni vajza të reja dhe nesër do të bëheni nëna, bashkëshorte dhe uroj të keni fat edhe të trashëgoheni.

## Pjesa e Katërt

**Anita Susuri:** Deshta edhe me folë për ni pjesë shumë të rëndësishme në vitin '81, kur kanë shpërthyer demonstratat. Ku keni qenë ju? Çka keni bo?

**Binak Ulaj:** Në vitet '81, unë ju thashë edhe ma herët, për ne ka qenë problemi i të përndjekunit të, na çka jemi në punë, ju thashë kom qenë fëmi i vetun, kisha vetëm një nanë, që ishte problem të jetonim në katun atje, aq ma pak se ishte një fshat afër kufinit. Mbikqyrja ishte e jashtëzakonshme në vijë ajrore une e kom pasur njiqind metra, 120 metra postën e ushtrisë kufitare. Dhe duhet, do të thotë, të largohesha, të gjejë ndonji punë për arsye se jo vetëm që ishte burim për ekzistencë puna, se nuk kisha të ardhuna tjera, por ishte edhe një formë për të vepruar më gjatë. Kur je pa punë, kur je pa të ardhura osht' ni çështje, do të thosha e padurueshme, në kushte të cilat as nuk mund të veprësh. Dhe para se të shpërthejnë demonstratat, do të thotë, me 11 mars të '81-shit në Menzën e Studentëve dhe ma pas me 1-2 prill, do të thotë mu do t'më arrestojnë. Atëherë isha në Therandë, përkohësisht në Suharekë si thuhet, se s'po mund të mësohemi ta quajmë Therandë. Punoja si përkthyes në "Ballkan", edhe aty më kanë arrestu, më kanë dërgu në burg të Prizrenit ku kom qëndru ni periudhë, pastaj në burgun e Mitrovicës.

**Anita Susuri:** Çfarë aktakuze keni pasë atëherë?

**Binak Ulaj:** Urdhëno?

**Anita Susuri:** Çfarë aktakuze atëherë keni pasë?

**Binak Ulaj:** Atëherë na kanë marrë në burg me aktakuzën, e qujshin "izolim" përkatësisht, "qëndrim në vend të caktuar", as edhe ni fakt, ishte vetëm një lloj do të thosha një lloj...

**Anita Susuri:** Me ju parandalu...

**Binak Ulaj:** Kamoflimi i asaj, se ne na çonin në burg, na merrshin në pytje, në hetime sikur se të ishim të akuzuar për vepra të randa penale.

**Anita Susuri:** A ju kanë gjyku, po mendoj a ka...

**Binak Ulaj:** Nuk na kanë gjyku, mas tre muje katër, tre muj e disa ditë përsëri na kanë liru për mungesë të fakteve. Se, thashë edhe niherë, një ndër detyrat kryesore të neve të përndjekurëve ka qenë të mos i pranojmë veprimtarinë, për arsye se të pranosh veprimtarinë ti ke vazhdu me, kush ka qenë ai, edhe kjo e damton edhe lëvizjen. Për fakt, për mungesë të fakteve do të thotë na kanë liruar. Në atë periudhë, po thom, se çka kanë qenë torturat, ndonëse në izolim, po them edhe niherë që kushtimisht ishte një lloj maskimi i veprimeve të tyre Xhemajl Berishën e mbysin edhe e gjuajnë prej Burgut të Qarkut e në Prizren dhe e mbysin. Një djalë të ri, një djalë, të... Urdhno?

**Anita Susuri:** Kur keni qenë ju a po? Ka ndodhë kjo?

**Binak Ulaj:** Në vitet '81 {lëvizë kokën në shenjë pohimi}. E njejta gjë ka ndodhë, e njejta gjë ka ndodhë... Urdhno?

**Anita Susuri:** Qysh ke krejt për juve kjo?

**Binak Ulaj:** Po, si pritët? Si mund ta presësh, do të thotë, kur ndëgjjon diçka të tillë. Por, kjo osht' ajo që ti përveç ndjeshmërisë, dhembjes, osht' ni ndjenjë e cila ty të bon se duhet të jesh ma i qëndrushëm, edhe ma i vendosur për ta ndjekur edhe për ta realizuar idealin tonë për cilin je përcaktuar. Kjo ka qenë ajo. Po të them edhe niherë unë, njeriu i Lëvizjes Kombtare Ilegale, ai e bon ni jetë do thojsha me nifarë mënyre, të mos thom jetë, shnëdrohet me ni lloj gjysmë-automati, automat do të thotë, roboti, të mos them automati. Për arsye se ndjenjat, na gjithmonë duhet nënshtuar arsyes, logjikës, mendjes, si të veprosh, si të bojsh, çka të bojsh tash? Jo tani që për shkak të ndjenjave të dhembjes e të tjerat të pësosh ose të mos mund të veprosh.

Kjo është një element që ndoshta për fat të keq nuk e theksojnë sa duhet, post-torturat e tjerat. Kjo osht' ajo me peshë që duhet theksuar, do të thotë, koncepti i qëndresës i të përndjekurve dhe të burgosurve politikë, bindja ndaj realizimit të idealeve. Ne e kemi pasë moto të jetës, "Çdo gja për çështjen, asgjë mbi çështjen". Kjo ka qenë moto e veprimtarisë të grupit, i cili falë moszbulimit të shokëve nga viti '68-'69 kur ka arritë në '81 e tutje. Hidajeti po e zamë ka hi në vitin '81, Mehmet Ajrizi, Jashar Alia, për here të dytë e kështu me rradhë.

**Anita Susuri:** Pas vitit '81 pastaj fillojnë edhe nifarë lloj diferencimi, largimi prej...

**Binak Ulaj:** Ajo natyrisht, ajo dihet. Përcjellësit, do të thotë, fillon një diferencim megjithatë në '81-shin pastaj do vazhdoj të punoj përsëri. Do të thotë, ma mundësuan, por si përkthyes, si përkthyes.

**Anita Susuri:** Aty ku keni qenë në "Ballkan"?

**Binak Ulaj:** Po, në "Ballkan" të Therandës. Pastaj kam kalu në Prishtinë, për arsye se "Ballkani" ishte qendër e vogël dhe përcjellja ishte shumë e lehtë aty. A din, qendra e vogël, une banoja aty në atë hotelin e punëtorëve. Nuk e di ju sa e dini, "Ballkani" ka qenë njëra ndër firmat ma fitimprurëse në vitet e fundit të viteve të '70-ta deri '81, po kjo s'ka të bëjë shumë me rëndësi. Dhe banoja aty në hotelin e punëtorëve, e kanë pasur menzën e punëtorëve dhe ajo ishte për mu një lehtësi. Mirëpo, mundësitë e lëvizjes, veprimtaritë ishin tejmasë të kufizuara. Prandaj kam kërkuar edhe për fat kam gjetë përkrahje dhe jam punësuar në Entin Social për Sigurim Invalidor të Kosovës, dhe kam kaluar këtu deri në vitin '89.

Kur po ashtu, do të thotë, pas suprimimit të asaj gjysë autonomie që kishte Kosova, përsëri do të marrim së bashku me disa qindra intelektualë kosovarë dhe do të na dorëzojnë në Sërbë sikur ne të ishim pengje lufte. Kjo ka qenë një, një, periudhë po ashtu po them jashtëzakonisht e randë, e randë

edhe në aspektin shpirtëror, për arsye se na e dërguan organet tona, në vend që të na mbajnë këtu në Kosovë ata ana dorëzuan atje në burgjet e Sërbisë ,sikur ne të ishim rob të sërbeve, jo qytatarë të Kosovës, shqiptarë. Kjo ka qenë tepër e randë.

Për torturat e burgut të Leskovcit, nuk ju flas ose të Prokoplës, të Vranjës, të Burgut Qëndror për arsye se ato edhe janë përshkruar në disa vepra. Por me të vërtetë kanë qenë tortura, të cilat në një mënyrë... por për fat të keq përsëri po e them, falë përcjellësve tanë gardianëve që na përcollën edhe na dorëzuanë nëpër burgje. Ata meniherë kur u kthyen tregunë se si na kanë torturuar. Ju e keni pa nëpër filma si i kapin kriminelët, veç se nuk na preke krytë në tokë domethonë, të përkulke deri, deri në skaj... dhe të gjitha torturat, do të thotë, baheshin në prani të mjekut, me pa deri sa mun qëndron, dhe ma të randa ishin torturat kur dilshe lakuriq.

Po ju tregoj një rast pak interesant, une e kisha një xhup, se përafërsisht e dija, e dija se çka do, une s'do e zgjas shumë se kjo osht' rrëfim i gjatë, por e vështa xhupin se e disha thashë edhe nëse të mëshon e knejna pak e duron ma lehtë. Po thotë, "Hiçe kadale ato, hiçe kadale ato, se këtu te na osht' shumë nxehtë", edhe ashtu ishte, ti nxeheshe prej të rameve. Mjeku ishte aty, domethanë, të pyste, "A je i sëmurë? A ke qenë?" Dhe nuk më lejoi ndoshta karakteri nuk e di të i thom se kom qenë i sëmurë, po edhe në të vërtetë s'kisha qenë i sëmurë a. Dhe pastaj, zhveshja, rremja, kur ishe ti lakuriq, unë jam befasuar, edhe tash befasohem se si trupi kërcente prej dyshemesë që ishte prej llastikut, kur të godisin.

Fati që u alarmu gjendja jonë, e alarmunë përcjellësit tanë. Ma vonë kom gjetë shënime se kishte alarmu njani këtu edhe Sekretariati prej brendshmi, u alarmu në Komitetin Qëndrorë që ishte, se të mos harrojmë se ne pjesëmarrësit në Federatën Jugosllave në Komitetin Qëndror përbërja e kësaj nga kroatët e sllovenët ne na e ka shpëtuar. Ata e ngritnin zërin gjithmonë, edhe për interesa të veta po edhe në favor tonit. Dhe pas disa ditësh, do të thotë, torturat ndryshuan, me dënu i kanë dënuar pastaj, i kanë fikur gardianët për sjellje të tillë. Ne na kanë marrë në pyetje dikun këtu në Prishtinë, dikun në Leskovc, se une nuk kom shku se e disha që ajo osht' veç ni farsë. I kanë dënuar shumë rëndë gardianët sërbe me kusht nëse s'e përsërisin (qeshë). Kjo ishte ajo...

**Anita Susuri:** Qysh ka ndodhë krejt kjo marrja e juve? Qysh keni shku deri atje nëse mundeni...

**Binak Ulaj:** Jo marrja, do të thotë, ndëgjo të lutem, ndoshta s'di tash po, në librin e rrëfimeve nga burgun unë e kam përshkruar këte. Në momentin kur osht' shpallur gjendja e jashtëzakonshme, e kom ditë që na kanë me na marrë, se edhe në '81-shin kështu ndodhi, dhe i kom thonë familjes që t'i përgadis, "Me siguri do të më marrin", dhe kështu ka ndodhë. Si u shpallë gjendja e jashtëzakonshme, gjendja e shtetrrethimit, si osht' shpallë në mëngjes kam qenë veç i gatshëm. Nuk jam munduar të iki, po them edhe niherë, për arsye se e kisha familjen edhe tjera tjera. Edhe të them të drejtën, sinqerisht nuk mendoja se do na dërgojnë në Sërbi.

Na kanë grumbulluar në Sekretariatit e Punëve të Brendshme, aty janë rreth objektit që osht' i ngjitur me Burgun [e Prishtinës] e keni parë aty, edhe tash osht' objekt i policisë dhe Sekretariatit. I kanë mbledhur nga të gjitha qendrat e Kosovës, dhe nuk dinim ku na dërgojnë. Për fat njeni prej tynve, i cili osht' poashtu osht' torturu jashtëzakonisht, Bedri Novosella, e pys, "Bedri more, ku po na dërgojnë knej". Tha, "More, do të na dërgojnë në Leskovc". E kështu kumeditë si e kishte marrë vesh. Thotë, "Edhe to të na e k... e tjera, e tjera", edhe ajo ndodhi, do të thotë ka qenë ni, ni, ni...

Ishte e rondë edhe më vjen inati. Dy momente kanë qenë shumë të rana për mu gjatë asaj periudhe. Nji ishte momenti kur bërtitja, dilte zëri pa dashtë nga dhembja, "Oh", edhe më thoshin, "Ah kjo 'Oh' nuk përkthehet a?" Se une i thashë, "Jom përkthyes". "Ah, kjo s'përkthehet, ose si përkthehet kjo hajt kallxo?" "Po si përkthehet? Kjo s'përkthehet". "Ah, s'përkthehet mirë". Edhe e dyta ishte si duket... po ju them edhe diçka, kjo osht' mirë ta dini ju si të ri edhe normal ndoshta dikujt mund të i interesoj. Kam menduar që atë natë domethonë përfundoi jeta ime, asht' për t'u çuditë, nuk më binte në mend për askand tjetër në botë. E vetmja gja që e mendoja, se ishte terr në atë rrethinën ku na vendosën, e vetmja gjë ishte që thashë, "Paska edhe djem tjerë dhe do dijnë të tregojnë". Kjo ka qenë.

Pas ni kohe, meqenëse e kam humbur vetëdijen, kanë ardhë, më ka mbetë si duket goja hapur {përshkruan me duar formën e gojës} ma kanë futur gërrbaqin. Oh, i kom hapë sytë. Kanë thonë, "Mirë, gjallë qenka". Dhe çka më ndodhi edhe diçka, osht' e turpshme ta them, kam pasë njifarë lloj force nuk e di, më ka kapë barkqitja, nuk kishim ujë, s'kishim ujë, letra, ato mund ta merrni me mend. Dhe përsëri të nesërmen kur kanë ardhë me na i dhonë vendimin që ne jemi kinse të izoluar. Po ashtu, kemi përjetuar tortura, po meqë u alarmu Sekretariati, Kosova, Prishtina, erdh ni delegacion prej... përfaqësuesit të Sekretariatit të Prishtinës, përfaqësuesit e Sërbisë edhe të Federatës [Jugosllave].

Edhe më vjen keq që nuk kisha, nuk mujta, më vinte turp të deshem para tyre të ju them se, te shohin trupin tonë i cili ishte pothuaj i tëri, me përjashtim diku ku nuk e kapte gërrbaqi ose rënja ose tjera, përplot e përplot mavi nga hematomat. E më vinte keq të deshëm se i kisha të përlyeta ato brektë që i kisha edhe ata pantollë, se s'kisha forcë, as me çka të pastroheshim, as të pastroheshja, ka qenë ni moment i ranë do të thotë kjo. Dikuj i dukët pak... s'di si të them, po une p'e tregoj diçka që s'osht' turp se nuk ishte diçka që varej nga unë. Më vjen inati për, jo për ata që ishin përfaqësues të institucioneve, se për shkak të nji punëtori të Sigurimit të cilin e njifsha që ishte nga Prishtina.

**Anita Susuri:** Sa kohë keni qëndru këtu, a e din?

**Binak Ulaj:** Atëherë kemi nejtë dikun afër katër mujë, po prej atyhit meqenëse u ba mo edhe trajtimi i jonë në burgun e Leskovcit, atëhere na shpërndanë. Mu më kanë dërgu në burgun e Zajëçarit, aty i kanë dërguar Meriman Brahën, Xhemajl Pllanën, e kështu me rradhë, e tjerë, e tjerë, të cilët jonë në listë. Dikon në burgun qëndrorë të Beogradit e kështu me rradhë.

**Anita Susuri:** Gjatë kohës kur jeni liru mas këtyre mujëve, jeni kthy në shpi sigurisht në Prishtinë edhe atëhere ka qenë edhe koha që jonë largu prej punës njerëzit, edhe sigurisht edhe ju nuk e di a keni pasë mo probleme me ftesa për biseda informative.

**Binak Ulaj:** Që ta zbutim pak, të thash edhe njiherë që t'i zbuti pak masat une jom kthy përsëri në punë. Po, pas disa kohe kur janë futur masat e dhunshme në Entin për Sigurim dhe në institucione tjera, dhe në organizata tjera të punës, më kanë larguar si tepricë teknologjike. Ndonëse, une prej katër përkthyesëve, se aty kanë qenë tri të bashkësive qeverisëse për mbrojtjen shëndetësore, mbrojtjen e fëmive, edhe për pensione. Mu më larguan kinse kinse si tepricë teknologjike, por që ishte edhe ajo ma e rondë ju thashë edhe niherë, u konë fakti se ma morrën ma vonë edhe banesën, edhe më nxorrën me dhunë nga banesa. Pasi që më largunë prej atyhit, dhe meqenëse atëhere bonim një lloj aktiviteti, do të thotë informumë ato institucione çfare i kishim veshë pas arsimit, une iu ktheva profesionit tim punës në arsim, dhe kom qenë mësimdhanës në gjimnazin Xhevdet Doda, dhe ma vonë drejtor i këtij gjimnazi deri në vitin 2003.

**Anita Susuri:** Qysh kanë qenë këto vite, domethonë kanë qenë shtëpitë shkolla...

**Binak Ulaj:** T'e them edhe niherë kështu do të thotë, për fat, për fat anëtarët e kolektivit të gjimnazit Xhevdet Doda mas ni kohe, masi i lorgojnë, dhe meqenëse nxënës sërë kishte ma pak, ata krejt nxënës sërë atje ku ishte gjimnazi, ju e dini ku ka qenë gjimnazi, ku osht' katedralja tani, kvta kaluan këtu në gjimnazin Sami Frashëri, dhe ai metë zbrazët. Dhe falë atij kolektivit, edhe në ren të parë drejtoreshës që ishte para meje Zymryte Limani, një drejtoreshë e cila ka qenë për çdo respekt, kthehen ata aty, dhe kthehen edhe nxanësit. Dhe edhe për qëllime propagandistike si duket organet sërëbe nuk na largunë prej atyhit, se thoshin, "Ja ku e kanë gjimnazin, këta thonë nuk kanë shkolla po qe ku e kanë gjimnazin këtu", ka ndodhë që e kanë mbyllë me dyll të kuq kur kam qenë unë,

Pastaj drejtor veçse mas vitit '97 kur mësimi duhej të fillonte me 1 shtator e ne filluam të premtën, domethonë me 1 shtator ishte e premtë, sërëbët morrën vendim të nisin me datën 4 shtator, po ne megjithate e shpërfillëm, do të thotë, mbylljen e shkollës. Kishin vënë dyll të kuq, po nuk na largunë, p'e them edhe ni here, e përdornin si arsye pak për t'u arsyetuar për të thonë, "Ja qendra, në qendër të Prishtinës, në qendër të Kosovës e kanë shkollën". Kështu që, aty kam mbetur pastaj deri në vitin, si ju thashë edhe nji here deri në vitin 2003. Dhe pastaj për shkaqe që noshta s'kanë të bojnë me këto, do të thotë, për shkaqe që nuk mund të pajtohesha me një reformë e cila çrregulloi sistemin tonë arsimor, kom dhanë dorëheqje prej punës. Jom largu me vetë, do të thotë, jo me vullnetin tim, përkundër vullnetit, por jam larguar nga arsimit dhe kam kaluar të punoj në administratë.

**Anita Susuri:** Po, kisha dashtë me folë pak edhe për kohën e luftës, ju me shumë gjasë keni qenë sigurisht në Prishtinë...

**Binak Ulaj:** E të tregoj tash për kohën e luftës. Une gjatë viteve të '90-ta kam qenë kur ka qenë baci Adem Demaçi kryetar për Këshillin e të Drejtave të Njeriut, kom qenë kryetar i Këshillit për të Drejtat e Njeriut. Së bashku me Shaban Shalën, i cili do të shkoj në luftë, do të arrijë gradën ushtarake gjeneral, do të bie dëshmor, dhe do të jetë hero i Kosovës së bashku me vëllaun Bedri Shalën, nanë e cila ndërroi jetë para tri ditësh. Dhe gjatë asaj kohe, do të thotë, isha edhe punëtor, profesor në gjimnaz, edhe nënkryetar i Këshillit. Dhe kam vlerësuar, se qëndrimi im, organizimi i punës në ni institucion të tillë shkollor çfare ishte gjimnazi do të jetë shumë ma i vlefshëm se sa shkurja ime në bashkëngjitja ime në rradhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Dhe e vërtetë, ashtu e kanë vlerësuar edhe të tjetër, edhe shoktë, pse po ju them këte? Po ju jap ni shembull, më kujtohet ni rast kur e kam lexuar librin për Che Guevarën, thotë, "Isha në dilemë", se ai ka qenë, ka studiju mjekësi, edhe rastësisht takohet me Fidel Castron edhe thotë, "për herë të parë u gjinda në dilemë, a të marr pushkën e të jem ni luftëtar i dobët apo çantën e mjekut?" Megjithatë e merr pushkën e tjera, dallohet, e keni dëgjuar për të? [i drejtohet intervistuesës]

Edhe une e vlerësova që kontributi im, kontributi im, do të thotë, edhe përkrahja ime nga ni institucion, edukimi i atyre nxanësve, shpjegimi i qëllimit, se ish, ka qenë dilemë. Është shtrur propaganda e tmerrshme kundër UÇK-së, ju nuk e di a e dini, [i drejtohet intervistuesës] quheshin dorë e zgjatur e Beogradit, quheshin terroristë, e të tjera, e të tjera. Unë ndonjherë tjetër kur do takohem me ju do t'ua jap librin e kujtimeve të gjimnazit edhe do e shihni, aty e kemi nxjerrë revistën "Gjimnazisti". E në ballinë të "Gjimnazistit" është emblema e UÇK-së, e në brendi të "Gjimnazistit" është betimi i UÇK-së, edukimi i këtyre nxënësve në frymën e UÇK-së. Do të thotë, për mua ka qenë kontributi ma i madh i Lëvizjes Kombëtare, edhe ma i madh se gjatë viteve kur kam qenë në Lëvizje aktiv, në Lëvizje Ilegale Kombëtare.

Do të thotë, kontributi im në gjimnaz ka qenë shumë ma i vlefshëm, sesa gjatë Lëvizjes, ndoshta ilegale, për arsye se, falë përkrahjes të disa arsimtarëve, jo të gjithëve, e kemi nxjerrë përveç ligjeratave, mësimëve, e kemi nxjerrë revistën "Gjimnazisti", që do të u a jap një ditë kur doni, kur të keni qef, edhe do e shihni. Kjo revistë, në ballinë, në faqe të saj të parë, në ballinë do të thotë e ka emblemën e UÇK-së, e në brendi e ka betimin e UÇK-së. Dhe nxanësit tanë, redaktorët e kësaj, shkojshin në zona të luftës. E dërgonin "Gjimnazistin", do e shihni aty, dhe do merrnin edhe sillnin informata që do botohen në këtë revistë. Nuk ka ndodhë kjo në atë kohë në ndonjë revistë të bahet diçka e tillë. Kjo ka qenë periudha e cila, jo meritë veç e imja, të mos them edhe ni herë të mos jetë, po edhe ni numrit të arsimtarëve të cilit ishin të kësaj ideje, që e përkrahnin edhe luftën edhe ata djemtë që i kishin rrokë armët.

Duhet të them edhe ni herë, kishte që na e thoshin që, "Nuk duhet politizuar nxanësit me veprime të tilla", se ju e dini krahu politik i atyre që e quanin një, "rezistencë paqësore", që në fakt s'ishte as rezistencë paqësore, po s'duhet të hyjë anejna se ju jeni të reja. Thoshin, "Mos politizim të shkollës", nuk osht' fjala për politizim, ishte fjala mos, jo vetëm politizimi po ishte politizim negativ të mos i edukosh ata nxënës në frymën e qatij idealit të cilin luftonin ata djem edhe vajza të cilit i kishin rrokë

armët. Mund të mos të pajtoheni, mund të ju duket kjo pak... po kjo ishte do të thotë, të mos i edukosh në atë frymë, të atynve djemve, ishte politizim negativ i të rijëve. Të gjitha protestat që i kem organizu kundër krimeve në Drenicë, nuk ka pasë nevojë [me i shty me dalë], nxanësit tonë kanë dalë. Ne me shfaqje, me recitime, me mbulimin e sheshit dhe bashkangjitime [në protesta], ka qenë diçka të cilat për fat ni pjesë e kësaj veprimtarie dhe këtij aktiviteti jonë dokumentuar.

**Anita Susuri:** A keni qenë gjatë gjithë kohës në Prishtinë kur ka ndodhë edhe për shembull bombardimi...

**Binak Ulaj:** Eh, jo. Mandej kur kanë filluar bombardimet e NATO-s me 24, mos të gaboj, me 24 mars [1999], une kam qenë me ni lagje, se atëherë isha pa banesë ju tregova, kom qenë me ni lagje këtu te teatri Dodona. Për fat të keq, do të thotë, një patrollë policie prej katër vetëve pesë, na kanë nxjerrë me rradhë, së pari e kanë shprazë pjesën e Velanisë atje. Une u bëja apel atyne fqinjëve që të mos dalin, se megjithate kisha një lloj autoriteti edhe si anëtar i... si nënkryetar i Këshillit për të Drejtat e Njeriut dhe si punëtor i arsimit. Por janë rënditë, urdhëruan që të dalin prej atyhit edhe kam qenë, ni kohë e kam kaluar në rrethin e Gostivarit, ni fshat.

Por, meqenëse ishim shumë anëtarë në familje, osht' interesant edhe kjo që ju jem mirënjohës përjetësisht aty familjeve, tre vëllazër na kanë marrë. Unë, nona me djalë kanë qenë me ni familje, unë me Qëndresën vajzën e vogël me ni familje, ndërsa Arbërorja edhe Lirika kanë qenë me ni familje, po ishim mrena ni oborri. Kjo ka qenë diçka, do të thotë, interesant. Këtë e theksoj për mirënjohje që na kanë pritur, ka qenë ni mrekulli e veçantë angazhimi i të rijëve, të rejave shqiptare nga Maqedonia. Përveç familjeve, natë e ditë nuk kanë pushuar, nuk e di unë, ju jeni të reja s'e keni përjetu, natë edhe ditë, për asni moment nuk kanë pushu traktorët dhe ndihmat që i kanë sjellë nëpër kamp, qoftë në Bllacë, qoftë në Sankovec, qoftë nëpër këto qendrat tjera.

Gjatë asaj lufte, një ndër momentet ma të fshtira të jetës time ka qenë rasti kur jam informuar për vrasjen, ekzekutimin e Bajram Kelmendit me dy djemtë. Une kam qenë, se e bonim ni lloj kujdestarie në Këshillin për të Drejtat e Njeriut, selia e të cilit ka qenë në... ku osht' tash Fakulteti i Studimeve Islame, kryetar i atëhershëm i Bashkësisë Islame i nderuari Rexhep Boja, për të cilin kam një respekt të veçantë gjithmonë, ka ndërruar jetë që sa kohë. Ai ka kriju një zyre aty, dhe kur kam shkuar në mëngjes, kam gjetë afishet të cilat i kishin shpërndarë serbët, ku bonin thirrje popullit që ta lshojnë Kosovën se në emër të UÇK-së se kinse nuk mund të iu mbrojnë, e tjera, e tjera.

Dhe pasi që kishim marrë vesh që i kanë marrë policia dhe nuk dinim për fatin e tyre, nëse s'gaboj dikun ditën e tretë, tek ditën e tretë, thërret dikush nga Kryqi i Kuq, një punëtoare aty, Marta nëse s'gaboj, edhe më thotë, "Bajrami me të dy bijtë janë", thotë, "të vlarë, në dalje të Prishtinës në drejtim të Fushë Kosovës". Kam shkuar, e kom marrë profesoreshën, nuk më kujtohet Igballe nëse s'gaboj, s'jom i sigurtë, gruen e Ymer Jakës që ishte poashtu profesor i Universitetit dhe anëtar i Këshillit për të

Drejtat e Njeriut. Dhe kam shkuar të i thom Nekibës, kur kam shkuar aty jam vetëdijësu. Kom thonë, “Po a jom në veti une, si të ja them një lajm të tillë?” Nuk ja kom thonë.

Mandej, do të thotë ka qenë një ndër lajmet ma të hidhura, ma të tmerrshme. Përveç kësaj kur kom shku ta shoh Nekibën, se e kam njoftë Nekibën, natyrisht edhe, ajo ka qenë edhe Nekibja edhe Bajrami kanë qenë jo vetëm anëtarë të Kryesisë të Këshillit, po Bajrami bashkë me, me... qe tash njeriu i harron, bashkë me ni grup anëtarësh të kryesisë avokatësh, Fazli Balaj... edhe e kanë dërguar aktakuzën e parë kundër Millosheviqit në Hagë. Për atë arsye, ata ju hakmarrën keq Bajramit se ka qenë avokati ma i njohur i Kosovës. Dhe jom kthyer pastaj nuk kam mundur t’i them, Nekbija më tregoi si ja kanë thyer derën, si ja kanë lanë nën shkallë minat e kurdisuna, veç me i prekë, shpërthyes, e tjera.

Jonë rrëfime këto që une shpresoj që një ditë këto, qata ju thashë nihere, osht’ koha që unë të tërhiqem prej të gjitha këtyre aktiviteteve dhe të i përkushtohem, do të thotë, shkrimi të kujtimeve. Sado që jonë zbehur, për fat të keq, edhe ndonji projekti që e kam kështu këndsor.

**Anita Susuri:** Pasi që e keni përfunduar me... domethonë në 2003-tën që thatë që keni qenë drejtor, kur e keni përfunduar këtë pjesë, jeni angazhu pastaj më tregutë për, për çka ishte se harrova (qeshë).

**Binak Ulaj:** Jo, do të thotë ma vonë, shumë ma vonë do të thotë, mas vitit 2003 unë kam punuar si përkthyes. Jam marrë edhe me përkthime, kam përkthyer një libër që asht’, e trajton edhe me njifare mënyre e përfshinë edhe fatin e të rinjëve shqiptarë, e ka botuar “Koha”, po s’osht’ shumë me rëndësi ajo. Po une pastaj kom qenë, jom angazhuar pastaj edhe me Shoqatën e të Burgosurve Politikë, e ma vonë jam zgjedhur, emëruar se jo zgjedhur, ambasador i Federatës të Paqes Universale, dhe për ni periudhë edhe tani kam qenë kryetar i Federatës për Paqe Universale në Kosovë. Osht’ ni Federate që i ka përfaqësuesit në 62 shtete të botës, jonë kryesisht ish-kryetarë shtetesh, osht’ z.Mojsiu, osht’ Fatmir Sejdiu, shembull po i marr këta, jonë Stipe Mesiçi e tjera, e tjera. Kom pasë fatin edhe nderin të jem edhe me Sumitin Botëror edhe para pandemisë në Seoul ku e kam takuar shefin e NATO-s, e tjerë, e tjerë. Do të thotë, jonë raste të cilat, me statut nuk kam drejtë me u konë mo kryetar, veç dy vjet. Dhe meqenëse jam plakur tash, do të thotë, ja kam dorëzuar këtë detyrë dikujt tjetër.

**Anita Susuri:** Tash edhe me alpinizëm po merreni në qoftë se s’gaboju...

**Binak Ulaj:** Çështja e alpinizmit osht’ çështje po thom, e pasionit tim, i cili si duket do të thotë unë shpesh here e kam menduar edhe atë, “Sa e përcakton jetën e njeriut kushtet në të cilat lindë?” Unë kam lindë në mal, në bjeshkë, mund të jetë ndoshta kur i kam hapur ata sy, ndoshta s’kam ditë çka osht’ bjeshka, çka osht’... po, mund të jetë ka mbetë në ndonjë pjesë, në ndonjë qelizë të trurit kjo. Por edhe fakti që pastaj kemi dalë shumë vera në bjeshkë me bagëti, kur ishim me një bashkësi ma të gjerë familjare, dhe fakti ndonëse kemi ecur shumë keq, se në atë bjeshkë ku veronim, jam ngjitur në Valbonë që ju paskit qenë dhe pjesë jo larg Thethit. Jonë bjeshkë të vrazhgëta, të zhveshura, në maje

shumë të thikëta, me hone të thella, ku nuk shkrinë bora gjatë gjithë verës, ku s'ka ujë, por borën e shkrinim dhe e përdornim që ta pijmë, edhe për larje edhe për kafshë.

Por, pjesa tjetër e jetës në atë lartësi mbi 2000 metra, bashkësia dhe rrethanat e përbashkëta, problemet e përbashkëta që kanë, do të thotë, kanë krijuar te unë, do të thotë, një dashuri që i kalon ndoshta skajet e nji pasioni dhe unë shpirtërisht jam i lidhur me bjeshkën, me alpinizmin, për aq sa më lejon moshë se e po aty gati tash ka shkoj kah të 80-tës. Edhe falë këtij aktiviteti do të thotë, edhe falë faktit që si duket kam shpëtuar gjatë burgjeve pa ma dëmtuar ndonjë organ vital, jam ky që jam ende që mund ta sfidoj moshën. Ndoshta, ndonjiherë në këtë moshë ka qef, nuk e di, e uroj të plakeni edhe ju me shëndet, kur t'ju vijë koha natyrisht, kur thom me shëndet, kur të vjen koha.

Ka qef njeriu ta sprovuj vetën, të mos dorëzohet, sikurse edhe gjatë jetës me sprova tjera. Bon një lloj, sfidon pleqërinë dhe nuk kam dëshirë jom, prej natyrës ndoshta jam njeri që nuk kam qef të dorëzohem edhe nuk e kam kohën. Edhe kur smuhem kajherë i thom shoqës, "A po më len kaniherë une në ndonji rast të ankohe a jo?" Se femrat ma të ndjeshme jonë. Une kam mirëkuptim po e kam mërzi ankimet, kurrë hiç s'jam... po ju them edhe diçka kur e përmene, kur jam martuar, shoqe, motra e shokut të idealit, kam qenë me banesë me qira, i kom marrë dy kauqa të vjetër që i kom pasë gjatë kohës të studimeve i kem çu me shokët te mjeshtri, ni dollap të vjetër, edhe kështu ia kemi nisë prej zeros (qeshë).

**Anita Susuri:** Zotri Binak, nëse doni edhe diçka me shtu për fund, najsen që doni me cekë që mendoni që osht' e rëndësishme.

**Binak Ulaj:** Çka osht' e rëndësishme besoj ju kisha lutë edhe niherë si të reja që jeni, edhe ta keni parasysh vetëm vlerësoni kontributin e gjithë atyre brezave, gjithë atyre brezave që kanë dhanë kontribut, që kanë sakrifikuar për ju, për të ardhmen tonë, për Kosovën, për atdheun tonë. Kjo osht' kryesorja, gjithmonë ta keni parasysh kontributin e tyne, sakrificën e tyne. Dhe, dhe ta keni parasysh se ne jemi të këtij trollit, këtu duhet të jemi, mos synoni sikur shumë të rijë, do të kalojnë edhe këto vështirësi me të cilat ballafaqohet shteti i ri, vendi i ri, mos mendoni të dilni përjashta siç po dalin një pjesë e të rinjëve. Keni parasysh këta, këtu do të jeni dikushi, përjashta do të jeni qytetarë të tretë, të katërt, sado që të jeni të suksesshëm. Kaq kjo osht' porosia ime.

**Anita Susuri:** Faleminderit shumë edhe për kontributin edhe për intervistën.

**Binak Ulaj:** Faleminderit edhe ju.